

**RAPORT MONITORIMI**  
**MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS**

**(12 mujori 2010)**

Ministria e Arsimit dhe e Shkences për vitin 2010, ka administruar dhe menaxhuar fondet buxhetore, sipas gjashte programeve të miratuara, te listuar me poshte:

1. Programi “Planifikim, menaxhim dhe administrim”
2. Programi “Arsimi Bazë”
3. Programi “Arsimi i Mesëm i Pergjithshëm”
4. Programi “Arsimi i Mesem Profesional dhe Social-kulturor”
5. Programi “Arsimi i Larte”
6. Programi “Kërkimi shkencor”.

Detajimi i buxhetit për vitin 2010 është mbështetur në prioritetet e përcaktuara në Programin e Qeverisë si dhe në Programin Buxhetor Afatmesëm 2010-2012, sipas 6 programeve buxhetore ose niveleve arsimore ku janë mbajtur parasysh objektivat, qëllimi i synuar, përfituesit, si dhe lidhjet midis politikave sektoriale dhe aktiviteteve nga ku janë përcaktuar dhe buxhetet për çdo program, të parashikuara në PBA për periudhën 2010-2012.

**Buxheti i miratuar** me ligjin nr. 10190 datë 27.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, është 43 miliard e 508.9 milion lekë, 3.38% të PBB (ose 473 milion USD me kursin 1\$ =92 lekë). Buxheti i miratuar ka një rritje mesatare vjetore prej +5% ndaj buxhetit të rishikuar të vitit 2009.

Shpenzime korente/funksionale në buxhetin e vitit 2010, janë 35 miliard e 7 milion lekë ose 80.5 % e buxhetit me një rritje prej 220 milion lekë ndaj vitit 2009.

**Shpenzimet kapitale për investime**, sipas buxhetit janë 8 miliard e 501 milion lekë investime ose 19.5 % të buxhetit 2010.

Të detajuara sipas grup artikujve;

1. Shpenzimet për personelin janë 25 miliard e 175 milion lekë lekë.
2. Shpenzimet operative apo për shërbime dhe blerje mallrave janë 9.8 miliard lekë me një rritje prej 220 milion lekë ndaj vitit 2009.
3. Shpenzimet kapitale për investime janë 8 miliard e 501 milion lekë investime ose 19.5 % të buxhetit 2010.
4. Sipas burimit të financimit shpenzimet kapitale janë të financuara nga buxheti i shtetit 78.2% dhe financim huaj 20.8%. Financimi i huaj prej 956.2 milion lekë, ka si burim financimi Bankën Botërore dhe Bankat Evropiane në kuadër të projektit “Cilësi dhe barazi në arsim” në shumën prej 603.4 milion lekë ose rreth 63 % dhe financime të tjera nga BE Projekti IPA, KE Projekti CARDS, Qeveria Zvicerane, Qeveria Italiane në shumën prej 352.8 milion lekë ose 37 % e fondit.

**Buxheti i rishikuar** me ligjin nr. 10190 datë 27.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010” të ndryshuar (së bashku me fondin shtesë të pagave prej 900 milion dhe rialokimet me VKM për shtesë të buxhetit me 35 milion lekë , shkon në vleren **38 miliard e 390 milion lekë** ose **3.13% ndaj PBB dhe 10.13% ndaj shpenzimeve publike 2010** .

1. Shpenzime korrente/funksionale në buxhetin e vitit 2010, janë 33,85 miliarde leke ose 88 % e buxhetit,
2. Shpenzimet kapitale për investim kapin vleren **4,57 miliarde lekë** ose 12% ndaj totalit te buxhetit,

**Të detajuara sipas grup artikujve;**

1. **Shpenzimet për personelin janë 30.7 miliard lekë.** (përfshirë dhe shpenzimet e personelit në IAL publike).
2. **Shpenzimet operative janë 3.1 miliard lekë** për shërbime dhe blerjete mallrave (duke zbritur shpenzimet e personelit në IAL publike, të përfshira në shpenzime personeli).
3. **Shpenzimet kapitale** për investime janë **4.57 miliard lekë**
4. **Sipas burimit** të financimit shpenzimet kapitale janë të financuara nga buxheti i shtetit në masën 78.2 % ose 3 miliard e 620 milion lekë dhe financimi i huaj me 956 milion lekë ose 20.8%.

5. **Financimi i huaj** ka si burim financimi Bankën Botërore dhe Bankat Evropiane në kuadër të projektit “Cilësi dhe barazi në arsim” në shumën 603.4 milion dhe financime të tjera nga BE Projekti IPA, KE Projekti CARDS, Qeveria Zvicerane, Qeveria Italiane në shumën prej 352.8 milion lekë.


**Realizimi i shpenzimeve për 12 mujorin 2010** në këtë program është në masën 85 % dhe përfaqëson rreth 2.1% të totalit të shpenzimeve të realizuara sipas zërave kryesore. Krahasuar me planin vjetor rezulton si më poshtë:

Shpenzimet korente	<b>98 %</b>
Shpenzimet kapitale	<b>82 %</b>
<b>Gjithsej</b>	<b>96 %.</b>


Tab\_1, Fondet buxhetore sipas programeve buxhetore të miratuar për vitin 2010, (buxheti i rishikuar) në mijë lekë.

Nr	Emri i programit	Buxheti Rishikuar (milion lekë)	Struktura Ne %	Realizimi 12mujor 2010		
				Ne milion /lekë	Struktura ne % ndaj buxh total	Struktura ne % ndaj realizim
1	Planif. menaxhim administrim	907	2.4%	774.8	<b>85%</b>	<b>2.1%</b>
2	Arsimi baze	23,645	61.6%	23,302.4	<b>99%</b>	<b>63.1%</b>
3	Arsimi i mesem i pergjithshem	5,167	13.5%	4,930.7	<b>95%</b>	<b>13.3%</b>
4	Arsimi i mesem profesional	2,275	5.9%	1,861.9	<b>82%</b>	<b>5.0%</b>
5	Arsimi i larte	6,168	16.1%	5,843.7	<b>95%</b>	<b>15.8%</b>
6	Kerkimi shkencor	228	0.6%	227.6	<b>100%</b>	<b>0.6%</b>
	<b>Totali</b>	<b>38,390</b>	<b>100.0%</b>	<b>36,941.2</b>	<b>96%</b>	<b>100.0%</b>

Tab\_2, Struktura e buxheti 2010 sipas grup artikujve buxhetore në %;



Tab\_3 Struktura e buxhetit të realizuar sipas programeve buxhetore në %;



Tab\_5 Fondet buxhetore sipas grup artikujve të planifikuara në PBA 2010, të miratuara për vitin 2010, planit të rishikuar, si dhe realizimi faktik për 6 mujorin Janar –Qershor 2010 në mijë lekë dhe në %.

Artikulli buxhetor	Emrti I artikullit buxhetor	PBA Plan 2010	Buxheti 2010	Buxheti i Rishikuar 2010	Fakti 12 mujor 2010	Diferenca 2010	Realizim në %Ndaj planit 2010
		(1)	(2)	(3)	(4)	(5)=(3)-(4)	(6)
600-601	Paga+Sigurime Shoqërore	25,198,000	25,176,500	30,757,747	30,309,659	-448,088	99%
602-606	Mallra dhe Shërbime të Tjera	9,871,000	9,831,200	3,055,928	2,891,360	-164,567	95%
230-231	Kapitale të Trupezuara Patrupëzuara	<b>8,635,454</b>	<b>8,501,224</b>	<b>4,576,534</b>	<b>3,740,145</b>	-836,390	82%
<b>Totali</b>	<b>Korrente dhe Kapitale</b>	<b>43,704,454</b>	<b>43,508,924</b>	<b>38,390,208</b>	<b>36,941,164</b>	-1,449,044	<b>96%</b>
	<i>Jashte Buxhetore</i>	<b>0.0</b>		<b>2,843,482.5</b>	<b>2,493,153.6</b>	<b>-350,328.9</b>	<b>88%</b>
	<b>Totali (korrente + kapitale) + jashte buxhetore</b>	<b>43,704,454</b>	<b>43,508,924</b>	<b>41,233,691</b>	<b>39,434,317</b>	<b>-1,799,373</b>	<b>96%</b>

Burimi: Ministria e Arsimit dhe Shkencës konfirmuar nga Ministria e Financës

Në mënyrë më analitike sipas gjashtë programeve buxhetore, realizimi i buxhetit dhe produkteve të parashikuara për periudhën 12 mujore 2010, paraqitet sa vijon;

### **I - PLANIFIKIM-MENAXHIM. (Titulli i programit 0111 )**

Buxheti i rishikuar për këtë program është **907 milion dhe zë rreth 2.3%** të buxhetit të MASH. Realizimi për periudhën 12 mujore ndaj planit vjetor në këtë program është në masëm 85%.

#### **Objektivat kryesore:**

1. Fuqizimi i planeve strategjike dhe aftësia e menaxhimit të financave në këtë sektor; - Përafrimi i legjislacionit kombëtar me atë të BE; -Shtirja e zbatimit të sistemit të menaxhimit me bazë performance në nivel DAR, - Rritja së kapaciteteve nëpërmjet trajnimeve, konsulencave, udhëzuesve e proceduarve të vetëvlerësimeve, - Trajnimi i drejtuesit të shkollave për realizimin e autonomisë, -Përmirësimi i procesit të auditimit dhe inspektimit.
2. Përmirësimi i menaxhimit dhe performancës së institucioneve arsimore (MASH dhe DAR/ZA)\_ - Zhvillimit profesional i stafit me një minimum 20% i stafit të trajnuar çdo vit (nga i cili 50% i stafit të përfshirë në proceset e planifikim – menaxhim dhe prokurimit).
3. Shtirja e EMIS në nivel shkolle. Zbatimi i sistemit të reformuar të financimit në nivel shkolle Sistem informacioni EMIS i zgjeruar dhe ne përputhje me standardet operationale në arsim, -sistemit të avancuar EMIS në kuptimin e zotërimit e përpunimit të dhënave statistikore nëpërmjet shtirjes së EMIS në 100% të DAR/ZA (30% e tyre në këtë vit

**Shpenzimet korrente sipas planit të rishikuar janë 873 milion lekë ( 8.7 milion usd).**

- ✚ **Zeri 600-601 Pagat dhe sigurimet shoqërore janë realizuar në masën 87% e fondeve të planifikaure ose në shumën 537.25 milion lekë,** për 748 punonjes.Pas ristrukturimit me VKM të DAR/ZA–ve numri i punonjesve ka ndryshuar sa vijon;
- ✚ Aparati i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës **116** punonjës (nga 122)
- ✚ Drejtoritë Arsimore Rajonale, 13 drejtori me **270** punonjës e specialistë (nga 387).
- ✚ Zyrtat Arsimore në Rrethe, 24 zyra me **240** punonjës e specialistë (nga 319).
  
- ✚ **Zeri 602-606 Shpenzime operative janë realizuar ne shumen 258 milion lekë, nga të cilat:**
  - ✓ shpenzime për krijimin e kushteve të punës dhe funksionimin e Aparatit të MASH rreth **59.1 milion lekë,**
  - ✓ shpenzime në kuadër te **projektit cilësi dhe barazi në arsim** prioriteti 1 me rreth 46.2 **milion lekë** (trajnimi i punonjësve të MASH, DAR, ZA në kuadër të sistemit EMIS, trajnimi i drejtorëve të shkollave, trajnimi i specialistëve të sektorit të prokurimeve, sektorit të buxhetit/investimeve analitike (më e detajuar në prioritetin 1 plani i aktiviteteve të miratuara për vitin 2010).
  - ✓ shpenzime për funksionimin e 13 DAR ne vleren **57.2 milion lekë** dhe 24 ZA, ne vleren **90 milion lekë** te institucioneve të vartësisë,
  - ✓ shpenzime “transfertë tek individët” për kompesim shpenzime karburanti” për zëvendësministrat dhe sekretarin e përgjithshëm ne vleren **1.1 milion lekë.**
  
- ✚ **Shpenzimet kapitale sipas planit të rishikuar, kapin vleren 34 milion lekë, me projektet kryesore:**
  - ✓ Rehabilitime të zyrave të Drejtorisë Arsimore Gjirokaster , rikonstruksion të rrjetit elektrik dhe internetit të MASH-it, si dhe pajisje të Mash-it, me **vlerë 2.834 milion lekë** , te cilat jane realizuar plotesisht.
  - ✓ Sistemi EMIS për DAR/ZA në kuadër të projektit ”Cilësi dhe barazi në arsim”, si blerje pajisje elektronike për projektin ”Cilësi dhe barazi në arsim”, **në shumën 31.2 milion lekë,** nga i cili janë realizuar vetëm blerje paketa office dhe softëere me vlerë **6.9 milion lekë.** Për aktivitetet e tjera, në këtë nivel, në kuadër të këtij projekti, janë lidhur kontratat dhe pritet realizimi i tyre gjatë vitit 2011.

Realizimi i shpenzimeve për 12 mujorin 2010, në këtë program është në masën 85 % dhe përfaqëson rreth 2.1% të totalit të shpenzimeve të realizuara sipas zërave kryesore. Krahasuar me planin vjetor rezulton si më poshtë:

Shpenzimet korente	<b>88 %</b>
Shpenzimet kapitale	<b>28 %</b>
<b>Gjithsej</b>	<b>85 %.</b>

Në këtë program janë parashikuar për t'u realizuar produktet e mëposhtem, ecuria e të cileve krahasuar me planin vjetor jepet në tabelën:

Kodi i Prod	Emri i Produktit	Buxhet Plan 2010	Buxheti Vjetor Rishikuar 2010	Fakti 12 mujor 2010	Realiz ne %
F	Krijimi i kushteve te punes per punonjesit ne MASH,DAR/ZA.	184,000	190,452	186,027	98%
K	Krijimi i sistemit te Monitorimit, Trajnimi i punonjesve te MASH, DAR/ZA ne kuader te sistemit EMIS.(cba)	25,000	20,000	13,418	67%
M	Pergatitja e akteve ligjore dhe neligjore, përafrimi i legjislacionit kombëtar me atë të BE	7,500	7,500	7,500	100%
J	Realizimi i shërbimit të auditimit dhe inspektimit, për institucionet arsimore publike dhe jopublike	8,800	8,800	7,500	85%
A	Rritja e kapaciteteve të burimeve njerezore nepermjet trajnimit te punonjesve ne MASH, DAR/ZA (cba), Konsulenca	36,700	21,187	6,698	32%
H	Trajnimi i drejtoresh te shkollave qe aplikojne autonome financiare	40,000	0	0	0
E	Trajnimit te punonjesve ne MASH, DAR/ZA/Inspektoriat per ritjen e kapaciteteve te burimeve njerezore.Konferenca	25,000	10,807	6,780	63%
D	Vleresimi i punes se punonjesve ne MASH,DAR/ZA.	618,011	614,299	537,250	87%
P	<b>Rehabilitimi i institucioneve arsimore te sistemit te menaxhimit DAR/ZA Aparati i MASH.</b>	780	0	0	0
I	<b>Blerja e pajisjeve elektronike dhe softve informatike per shërbimet ne MASH,DAR/ZA</b>	61,200	31,200	6,899	22%
B	<b>Ndertime te reja dhe konstruksione per permiresimi i infrastruktures ne MASH, DAR/ZA</b>	2,000	2,834	2,730	96%
L	<b>Hartimi dhe Dizajnimi i projekteve ndertimore dhe te rikonstruksionit ne DAR/ZA.</b>	54	0	0	0
	<b>TOTALI</b>	<b>1,009,045</b>	<b>907,079</b>	<b>774,802</b>	85%

#### Nga tabela e mësipërme, rezulton se disa produkte nuk janë realizuar;

1. Trajnimi i drejtoresh te shkollave qe aplikojne autonomine financiare, aktivite te parashikuara ne kuader te projektit anit "Cilësi dhe Barazi në Arsim", fondet për këto aktivite janë rishikuar/rialokuar.
2. Rritja e kapaciteteve në fushën e menaxhimit financiar, prokurimeve si dhe auditimi në MASH, aktivite te parashikuara ne kuader te projektit "Cilësi dhe Barazi në Arsim", u parashikuan gjate gjashtëmujorit te dyte 2010 nuk u realizun pas kufizimit të shpenzimeve me VKM 591 korrik 2010.
3. Blerje pajisje informatike dhe elektronike për sistem EMIS në MASH dhe DAR/ZA (CBA), procedurat jane në proces, janë realizuar vetëm 6.9 milion lekë.
4. Për produktet e tjera për ndertime dhe rikonstruksione, nga rishikimi i buxhetit, fondi i celur është realizuar 100%.

#### Faktorët që kanë ndikuar në realizimin e buxhetit për 12/mujorin e vitit 2010;

1. Ristrukturimi i DAR/ZA-ve, ka ndikuar në uljen e numrit të punonjësve në këtë program me afro 160 punonjës më pak për një periudhë 8-të mujore, ky faktor ka sjellë mos realizimin e fondeve të planifikuar për pagat e punonjësve.
2. Ndryshimi i VMK "Për krijimin dhe përdorimin e fondit të vecantë për vitin 2010", ka dhënë efekte negative në realizimin e fondeve të planifikuar për pagat e punonjësve.
3. Rishikimi i buxhetit dhe ndërprerja/kufizimi i financimit e shpenzimeve me VKM 591 korrik 2010, ka dhënë efekte negative në realizimin e fondeve të planifikuar për vitin 2010.
4. Ngurtësimi dhe më pas pakësimi i fondeve të detajuara per investime 51.2 milion lekë janë fonde të ngrira për vitin 2010, për 12 objekte, projekte, studimi apo procedura prokurimi. të parashikuara për investime në DAR/ZA
5. Miratimi me vonesë i planit të aktiviteve për vitin 2010 në muajin Mars, në kuader të projektit "Cilësi dhe Barazi në Arsim", e për pasojë shtyrja e afatit të prokurimeve për realizimin e disa të aktiviteve në kuader të projektit "Cilësi dhe Barazi në Arsim", të cilat kanë zënë një peshë të konsiderueshme në PVR dhe në buxhetin e MASH.

## II - ARSIMI BAZË. (Titulli buxhetor i programit 09120)

Buxheti sipas planit të rishikuar për këtë program për vitin 2010 është **23 miliard lekë e 644.6 milion lekë**. Buxheti i arsimit bazë zë **59.5%** ndaj totalit të buxhetit total të MASH Realizimi shpenzimet të buxhetit për periudhën 12 mujore është në masëm **99%** ndaj planit vjetor në këtë program.

### **Objektivat kryesorë :**

Sigurimi i një arsimit cilësor dhe për të gjithë nxënësit duke përmirësuar kushtet e mësimdhënies e mësimnxënies si dhe duke siguruar kushte të barabarta për pjesëmarrje në arsimin bazë, për të gjithë fëmijët e grup moshës në arsimin parashkollor dhe atë të detyruar.

**Objektivi 1-** Sigurimi i shërbimeve të arsimit që u jep mundësi nxënësve të zhvillojnë plotësisht aftësitë e tyre nëpërmjet: Rishikimit të kurrikulave të klasave të I-V të arsimit të bazë, Trajnimit të mësuesve bazuar në kurrikulat e reja për klasat V dhe IX dhe trajnimi i mësuesve që punojnë me nxënës të shtresave të marxhinalizuara në masën 2% çdo vit. Pajisja 100% e numrit të nxënësve me tekste shkollorë në kohë dhe me cilësi.

**Objektivi 2-** Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies në përputhje me standardet evropiane. Ndërtimi, rehabilitimi si dhe pajisje me mobilieri për klasat e reja dhe ato të reabilituar. Instalim i laboratorëve të kompjuterave. Instalimi i laboratorëve për shkencën me synim sigurimin e një laboratorit shkencor (kimi +biologji +fizikë) dhe një laboratorit (demonstrativ). Vlerësime kombëtare të provimeve të lirimt. Vlerësimi i punonjësve mësimorë nëpërmjet rritjes së pagave.

**Objektivi 3** – Mbështetja financiare nëpërmjet kompesimit të teksteve shkollorë, të nxënësve nga shtresat sociale në nevojë. Reduktimi me 0.2% në vit të numrit të nxënësve që braktisin shkollën duke siguruar mbështetje të vecantë për nxënësit në nevojë dhe fëmijët nga grupet romë/balkanogjiptianë/minoritare. Akses për parashkollorët në mënyrë që të rritet norma e regjistrimit nga 54% në 2008 në 62% në 2011. Sigurimi i transportit të mësuesve dhe nxënësve.

**Shpenzimet korrente** janë planifikuar sa vijon;

Në artikullin 600 – 601 “Fondi për Pagat dhe sigurimet shoqërore” janë realizuar në masën 99% ndaj planit 2010 ose **19 miliard e 978 milion lekë** lekë për rreth **30,200 punonjës**.

**602.** Shpenzimet operative janë realizuar 860.45 milion lekë ku përfshihen;

- ✓ Shpenzime për Institutet speciale, Instituti i fëmijëve që nuk dëgjojnë si dhe Instituti i fëmijëve që nuk shikojnë, 23 milion lekë;
- ✓ Shpenzime për Inpektoriati Kombëtar, Instituti i Kurikules dhe Trajnimeve Tirane **25.9 milion lekë**;
- ✓ Shpenzime për transportin e 13 000 mësuesve dhe 27.000 nxënësve për rreth **509 milion lekë**;
- ✓ Shpenzime për blerjen e mjetet didaktike, për 530 mijë nxënës - **30 milion lekë planifikuar**
- ✓ Shpenzime për sigurimi i aksesit në internet për 480 mijë nxënës ose furnizimi me internet 2107 laboratorë të informatikës (pas përfundimit të kontratës me Albtelekon)
- ✓ Shpenzime për trajnime të mësuesve në DAR- **20 milion lekë**;
- ✓ Shpenzime për trajnime të mësuesve në DAR, për nxënës nga shtresat e marxhinalizuara, si dhe uljen e braktisjes **2.5 milion lekë**;
- ✓ Shpenzime për blerje dokumentacion shkollor DAR/ZA, **15 milion lekë**,
- ✓ Shpenzime për aktivitete ekstrakurrikulare, olimpiada kombëtare apo ndërkombëtare, konferenca në MASH, 0.96 milion lekë
- ✓ Shpenzime për Vlerësimi i teksteve shkollorë si dhe veprimtaria e BOMIT 2010 libri shkollor – honorare vlerësimi 3.585 milion lekë, komisioni i vlerës **0.586 milion lekë**, shërbime hotelerie vlerësuesve 4.74 milion lekë. Në këtë aktivitet janë vlerësuar 189 tituj tekstesh shkollorë, dhe janë miratuar 107 tituj, nga të cilët 23 tituj janë me dy e më shumë alternativa.
- ✓ Shpenzime për blerje pulla me hologram **5 milion lekë**,
- ✓ Në kuadrin e programit Cilësi dhe Barazi në arsim për implementimin e skemës së financimit të shkollave përmes granteve aktivitete të pilotuar në 80-120 shkolla, aktivitete në drejtim të përmirësimit të kurrikulës, kualifikimit përmes trainimeve etj janë parashikuar **44.2 milion lekë** (nga të cilat për aktivitete në MASH 40.2 milion lekë dhe Instituti i Kurikules dhe Trajnimeve, Tirane **4 milion lekë** )
- ✓ **Shpenzime për në artikullin 606**, - Kompesimi i blerjes së teksteve shkollorë për rreth 120 mijë nxënës - **206 milion lekë**. Shpenzime për blerje e teksteve të minoriteteve dhe nxënësit në diasporë **31.8 milion lekë** ( 20 milion lekë tekstet e papaguara për vitin 2009 dhe të planifikuara për vitin 2010 rreth **11.8 milion lekë**)

## Shpenzimet për investime kapitale, janë **2 miliard e 605 milion lekë** (rreth 2.6 milion usd)

.Projektet kryesore

- ✓ Ndërtime të reja (financim - 9 objekte shkolla në kuadrin e programit Cilësi dhe Barazi në Arsim) me vlerë financimi **rreth 379.5 milion lekë**, për 9 objekte të reja arsimore, nga të cilat 1 e përfunduar plotësisht, 1 e përfunduar nga pikëpamja fizike si objekt por nga ana financiare mbeten edhe 13 milion për tu shlyer gjatë vitit 2011, dhe 7 objekte në vazhdim financimi në vitin 2011. Realizimi për këtë zë ka qenë **rreth 362.8 milion lekë** ose **95%** e fondit të çelur.
- ✓ Rehabilitime në kuadër të projektit "Cilësi e barazi në arsim" për 10 objekteve arsimore me vlerë **21.3 milion lekë**, për të cilat, në 7 prej tyre janë duke u zhvilluar procedurat e prokurimit nga njësitë vendore, ndërsa për 3 të tjerat janë duke u lidhur kontratat e hartimit dhe dizenjimit të projekteve. Realizimi në këtë zë është **6.2 milion lekë**.
- ✓ Për dy shkollat e përfunduara, Shkolla 9-vjecare Kamëz dhe Shkolla 9-vjecare Zallmner, u realizua fondi prej **9.6 milion lekë** për pajisjen me mobileri shkollore.
- ✓ Hartim dhe dizenjim projektesh për rehabilitimet dhe shtesat e shkollave ekzistuese me vlerë **8.4 milion lekë** dhe u realizuan rreth **5.4 milion lekë** ose **64%**. Çelja me vonese e detyrimeve 2009-2010, vonoi kryerjen e procedurave, megjithatë u realizuan një pjesë e tyre, pjesa tjetër nuk u realizua për efekt të pamjaftueshmerise kohore të kryerjes së procedurave të prokurimit.
- ✓ Investime pjesë e fondit të zhvillimit të rajoneve 2010, për objektet në vazhdim rreth **1.622 miliard lekë**, nga të cilat **875 milion lekë** për ndërtime të reja dhe **747 milion lekë** për rehabilitime, si dhe fondin për blerje pajisje mobilierie **422.8 milion lekë**. Me fondin e zhvillimit të rajoneve 2010 janë financuar rreth **125** objekte të reja dhe rehabilitime, si dhe furnizimi i tyre me pajisje.
- ✓ U financuan rreth 48 ndërtime objektesh të reja arsimore me një fond total investimi, nga buxheti i shtetit, prej **875 milion lekë**, 7 prej të cilave në vazhdim financimi në vitin 2011, dhe 41 të përfunduara. Realizimi në vlerë totale për ndërtimet e reja është rreth **858 milion lekë** ose në masën **98%**. Nga përfundimi i tyre përftohen 374 klasa të reja dhe nga ku përfitojnë rreth 8553 nxënës.
- ✓ Përfundoi rikonstruksioni i 74 objekteve në vazhdim financimi, rikonstruksione shkollash 9 vjeçare dhe të mesme të bashkuara, me një vlerë financimi prej **747 milion lekë** dhe të realizuar me vlerën prej **727 milion lekë**, nga të cilat u rehabilituan 979 klasa dhe përfitojnë 22674 nxënës. Janë në vazhdim financimi për vitin 2011, 3 objekte, të cilat u financuan në fund të vitit 2010.
- ✓ Për pajisjen me mobileri u financuan, nga buxheti i shtetit, fondi prej **422.8 milion lekë**, nga i cili u pajisën me pajisje mobilje rreth 140 shkollat e ndërtuara dhe rikonstruktura gjatë vitit 2009-2010 me një vlerë investimi të realizuar plotësisht prej **422.2 milion lekë**.
- ✓ Pajisje kompjuterike – **11.5 milion lekë**, të cilat janë realizuar – **8.9 milion lekë** në kuadrin e programit Cilësi dhe Barazi në Arsim.
- ✓ Pajisje laboratorike – **22 milion lekë** të cilat nuk janë realizuar (në kuadrin e programit Cilësi dhe Barazi në Arsim)
- ✓ Mobileri për laboratore shkencore **6.4 milion lekë**, të cilat nuk janë realizuar (në kuadrin e programit Cilësi dhe Barazi në Arsim)
- ✓ Pajisje mobilierie për kompjutera - **3.3 milion lekë**, të cilat nuk janë realizuar në kuadrin e programit Cilësi dhe Barazi në Arsim.
- ✓ Bibliotekat shkollore **30 milion lekë** të cilat janë realizuar me vlerë rreth **25 milion lekë** ose **83%**
- ✓ U krye financimi, për një pjesë të mbartur detyrimi nga viti 2009, për dixhitalizimin e amzave me një vlerë të realizuar prej **9 milion lekë**.
- ✓ TVSH dhe Kosto Lokale për projektin e Bashkisë Tiranë "Rehabilitimi i shkollave të Tiranës" në nivelin e arsimit bazë **44 milion lekë**, të realizuar për **30 milion lekë** ose **68.5%**

Realizimi i shpenzimeve për 12 mujorin 2010 në këtë program është në masën 99 % dhe përfaqëson rreth 61.7% të totalit të shpenzimeve të realizuara sipas zërave kryesore. Krahasuar me planin vjetor rezulton si më poshtë:

Shpenzimet korentë	<b>99%</b>
<b>Shpenzimet kapitale</b>	<b>95 %</b>
<b>Gjithsej</b>	<b>99 %.</b>

Në këtë program janë parashikuar për t'u realizuar produktet e mëposhtem, ecuria e të cileve krahasuar me planin vjetor paraqitet në tabelën në vijim

Kodi i		Buxheti Vjetor	Buxheti Vjetor	Fakti 12 M mujor	Realizimi %
Produktit	Emri i Produktit	2010	Rishikuar2010	2010	
E	Kurrikula të rishikuara dhe të rivlerësuara të Arsimit të Bazë.	0	0	0.0	0%
G	Pergatitja e teksteve shkollore,per arsimin baze.	88,000	206,696	202,242	98%
D	Realizimi i sherbimit arsimor për sitemin parashkollor	2,335,673	2,593,047	2,540,660	98%
B	Sherbim Arsimor per sistemin 9 vjecar.	17,090,422	17,677,310	17,541,135	99%
J	Sherbim interneti per nxenesit e arsimit baze.	29,016	0	0	0%
I	<b>Sherbim transporti per nxenes dhe mesues.</b>	380,000	509,013	509,013	100%
A	Shkolla që përfitojnë autonomi financiare	65,190	0	0	0%
H	<b>Trajnimi i mësuesve te arsimit baze.(CBA)</b>	20,200	20,200	17,880	89%
K	Vepretimari ekstrakurrikulare, olimpiada, festivale, aktivite.	0	2,500	2,000	80%
C	Vleresimet kombetare per provimet e lirimimit ne arsimin 9 vjecar (klasa e nente)	6,000	6,000	4,200	70%
F	Vleresimet nxenesve sipas standardeve nderkombetare, konsulenca (PISA, OECD etj) CBA	5,110	24,033	20,388	85%
A	Projekte nderitimore te hartuara dhe dizenuara sipas standardeve.	37,700	8,498	5,393	63%
A	Projekti i Keshillit Europes me Bashkine e Tiranës	44,000	44,000	30,147	69%
A	Laboratorë kimie, fizike, biologjie të pajisur dhe funksionalë	249,285	22,020	0	0%
A	Shkolla te reja te ndertuara sipas parametrave te kerkuar + CBA	1,238,458	1,110,419	1,081,182	97%
A	Shkolla te rehabilituara ne arsimin baze	879,720	640,904	612,094	96%
A	Kopshte te rehabilituara	128,000	128,000	121,600	95%
A	Shkolla dhe kopshteve te reja dhe te rehabilituara te furnizuara me pajisje	476,730	446,730	431,914	97%
A	Kabinetet e informatikes te pajisura dhe me mobileri	286,392	24,820	17,941	72%
A	Mobilimi per kabinetet e lendeve kimi fizike biologji sherben ne rritjen e efektivitetit te ores se mesimit.	90,600	6,400	0	0%
A	Kopshte te reja te ndertuara dhe te pajisura	144,000	144,000	139,680	97%
A	Bibloteka shkollore te krijuara	30,000	30,000	24,966	83%
	<b>TOTALI</b>	<b>23,624,496</b>	<b>23,644,589</b>	<b>23,302,435</b>	<b>99%</b>

#### Nga tabela e mësipërme del që disa produkte nuk janë realizuar;

1. Shkolla që përfitojnë autonomi financiare, nuk janë realizuar procedurat e prokurimit;
2. Të gjitha produktet të planifikuara për vitin në grupin e investimeve kapitale nuk janë realizuar në masën 100% për shkak të vonesave në miratimit të fondit të zhvillimit të rajoneve për vitin 2010 nga Ministria e Financës dhe pamundesisë për të rialokuar në projekte të tjera.
3. Ndryshimit të procedurave për objektet apo kontrata në vazhdim si dhe projektet e reja si me fondet e buxhetit të shtetit dhe me fondet në kuadër të projektit **Cilësi dhe Barazi në Arsim**;

#### Faktorët që kanë ndikuar në realizimin e buxhetit për 12 mujorit 2010:

1. Mosrealizim i procedurave dhe praktikave lidhur me programin e pilotimit të shkollave që përfitojnë autonomi financiare.
2. Ndryshimi i VMK “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të vecantë për vitin 2010”, ka dhënë efekte negative në realizimin e fondeve të planifikuara për pagat e punonjësve.
3. Rishikimi i buxhetit dhe ndërprerja/kufizimi i financimit e shpenzimeve me VKM 591 korrik 2010, ka dhënë efekte negative në realizimin e fondeve të planifikuara për vitin 2010 në artikullin 602 për blerje materiale didaktike mësimore, dokumentacion shkollor si dhe trajnime të punonjësve mësimore..
4. Miratimi me vonesë i planit të investimeve për vitin 2010. Shpërndarja me vonesë të grandit të investimeve për vitin 2010 me përfitues njësitë e pushtetit vendor (procedurat e reja VKM nr. 135, datë 3.2.2010, si dhe udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 11, datë 1.04.2010
5. Miratimi me vonesë i planit të aktiviteteve në kuadër të projektit “Cilësi dhe Barazi në Arsim”, në muajin Mars nga bankat donatore dhe Prill nga MF, e për pasojë shtyrja e afatit të prokurimeve për realizimin e disa aktiviteteve në kuadër të projektit “Cilësi dhe Barazi në Arsim”, të cilat kanë zënë një peshë të konsiderueshme në buxhetin e MASH. Disa nga aktiviteteve te projektit “Cilësi dhe Barazi në Arsim” janë në proces procedurat e prokurimit dhe vazhdojnë në vitin 2011

### III - ARSIMI I MESËM I PËRGJITHSHËM. (Titulli i programit 09230)

Buxheti i rishikuar për këtë program kap vlerën **5 miliard e 167.1 milion** lekë me **12.5 %** të buxhetit të MASH. Realizimi i buxhetit për periudhën 12 mujore ndaj planit vjetor në këtë program është në **masëm 95%**.

### Objektivat kryesore:

1. Përmirësimi i standarteve të infrastrukturës në AMP, duke ulur raportin e numrit të nxenesve/ klase, në zonat urbane nga 50 nxenes/klase në vitin 2008, në 45 nx/ klase në vitin 2009, në 35 nx/ klase në vitin 2010, Përmirësimi i raportit të sipërfaqes për nx, nga 0.80/m<sup>2</sup> në 2008 në 1.2 m<sup>2</sup> në 2009 në 1.5 m<sup>2</sup> në 2010 nepermjet:
  - 3% e klasave ndaj totalit ekzistues do të rehabilitohen në vitin 2010;
  - 3% e klasave do të ndërtohen të reja në vitin 2010;
  - 15% e shkollave do pajisen me laboratore shkencore në vitin 2010;
  - përmirësimi i raportit libra të rinj/libra stok, në bibliotekat shkollore me 15%.
2. Rritja e cilesise se mesimdhënieve nepermjet: Hartimit të kurrikulave të reja për klasën e 11(viti 2 i shk.mesme). Hartimit të teksteve të reja për klasën 10, Trajnimit të 33% të mesuesve për kurrikulat e reja të kl. se 10, Trajnimit të 33% të mesuesve për teknikën e reja të mesimdhënieve të aplikuara në vendet e BE, Trajnimit të 90% të vlerësuesve të testeve të maturës shtetërore, Paisjes së të gjithë nxenesve me tekste shkollore të miratuara dhe vlerësuar nga MASH.

### Shpenzimet korrente të këtij programi janë planifikuar 4.39 miliardë lekë ose 85% e shpenzimeve për këtë program buxhetor;

Buxheti në këtë program detajohet për 37 DAR/ZA dhe tre institucione nacionale, si Qendra Kombëtare e Vlerësimit të Arritjeve Tirane, Instituti i Kurrikules dhe Trajnimeve, Tiranë (i ndryshuar në IZHA) dhe Agjencia Kombëtare e Pranimeve në Arsimin e Lartë.(i ndryshuar në AKP)

**Shpenzimet për “Pagat dhe sigurimet shoqërore”,** janë realizuar në masën 99% ose 4 miliardë e 145 milion lekë për rreth 5 730 punonjës.(artikulli 600/601) afro 95 % e shpenzimeve korrente;

**Shpenzimet operative** në artikullin **602- 606. janë** 174.7 milion lekë ose 4.6% e shpenzimeve korrente, ku përfshihen;

Shpenzime për DAR/ZA për blerje mjetet didaktike e materiale të tjera mësimore,

Shpenzime për trajnime personeli e të ngjashme – **7.4 milion lekë,**

- ✓ Shpenzime për QKAVP - **90.6 milion lekë**
- ✓ Shpenzime për IKT – **3.2 milion lekë,**
- ✓ Shpenzime për APRIAL – **14.4 milion lekë**
- ✓ Shpenzime për blerje dokumentacion shkollor, **5 milion lekë,**
- ✓ aktivitete ekstrakurrikulare, olimpiada kombëtare apo ndërkombëtare, konferenca në MASH, **3.8 milion lekë**
- ✓ Shpenzime për vlerësimi i teksteve shkollore si dhe veprimtaria e BOMIT 2010 libri shkollor – **2 milion lekë,**
- ✓ Shpenzime për aktivitete për maturën shtetërore - **2 milion lekë,**
- ✓ Shpenzime për **aktivitete në kuadrin e programit Cilësi dhe Barazi** në arsim **5.3 milion lekë** Përgatitjen për implementimin e skemës së financimit të shkollave përmes granteve, fillimisht të pilotuar në shkolla.
- ✓ Forcimin i Qendrës së Provimeve nëpërmjet trainimit të stafit dhe zbatimit të një sistemi të ri administrativ, logjistik dhe teknik. (Përmirësimin e procesit të maturës shtetërore, QKAVP **1.5 milion lekë** , Aparati i MASH – **1.5 milion lekë.**)
- ✓ **Shpenzime për në artikullin 606,** - Kompesimi i blerjes së teksteve shkollore për rreth 30 mijë nxënës **42.8 milion lekë.**

### Shpenzimet kapitale 776.4 milion lekë,

#### Projektet kryesore janë;

- ✓ Ndërtime të reja **4** shkolla të mesme me vlerë **204.3 milion lekë** dhe të realizuara me vlerë **183.9 milion lekë** ose **90%.** (në kuadrin e programit Cilësi dhe Barazi në Arsim)
- ✓ Investime 2010, nga fondi i zhvillimit të rajoneve, ku vlera **403.2 milion lekë** është financuar për objektet në vazhdim të vitit 2009, **168 milion lekë** për ndërtime të reja, realizuar **92.8%** dhe **172 milion lekë,** rehabilitime, realizuar plotësisht, si dhe **63.2 milion lekë** pajisje mobilierie për objektet që kanë përfunduar gjatë vitit 2009 dhe ato të përfunduara brenda muajit shtator 2010, realizuar **59%** .
- ✓ U punua në 7 objekte të reja arsimore(nga të cilat 3 janë konvikte), në vazhdim financimi nga viti 2009, me një vlerë investimi prej **168 milion lekë,** e realizuar me vlerën prej **156 milion lekë** ose në masën **92.8%,** nga të cilat përfitojnë 190 klasa të reja dhe nga ku përfitojnë 1714 nxënës.



- ✓ U punua në 14 objekte për rikonstruksionin e tyre, me një vlerë investimi **172 milion lekë** e realizuar plotësisht. Nga këto 13 prej objekteve të rikonstruktura janë përfunduar dhe vetëm 1 objekt është në vazhdim financimi në vitin në vijim, objekt ky i miratuar në vitin 2010 dhe i financuar pjesërisht për vitin 2010. Nga përfundimi i tyre përftohen 164 klasa të rehabilituara nga ku perfitojnë rreth 4160 nxënës.
- ✓ Krijimi i fondit për bibliotekat me vlerë **20 milion lekë** i realizuar me vlerë 17.5 milion lekë ose **87.5%**.
- ✓ Pajisje mobilerie për shkollat e reja **12 milion lekë**, te cilat nuk jane realizuar, jane ne proces prokurimi në kuadrin e programit Cilësi dhe Barazi në Arsim.
- ✓ Pajisje shkollore DEMO për mësimdhënie në arsimin e mesëm **5 milion lekë**, te cilat nuk jane realizuar, jane ne proces prokurimi, në kuadrin e programit Cilësi dhe Barazi në Arsim.
- ✓ Pajisje laboratorike për **52.8 milion lekë**, te cilat nuk jane realizuar, jane ne proces prokurimi, në kuadrin e programit Cilësi dhe Barazi në Arsim.
- ✓ Pajisje kompjuterike në kuadër të projektit “Cilësi dhe barazi në arsim” me vlerë **24.6 milion lekë**, nga të cilat jane realizuar **1.28 milion leke**, pjesa tjetër janë në proces prokurimi.
- ✓ Studim-projektme – **2.37 milion lekë**, nga të cilat janë realizuar vetëm **174 mijë lekë**, pjesa tjetër jane ne proces prokurimi( në kuadrin e programit Cilësi dhe Barazi në Arsim)
- ✓ TVSH dhe Kosto Lokale për projektet e huaja në arsimin e mesëm të përgjithshëm **52 milion lekë**, realizuar **84%**.

Realizimi i shpenzimeve për 12 mujorin 2010 në këtë program është në masen 95 % dhe përfaqëson rreth 13.1% të totalit të shpenzimeve të realizuara sipas zërave kryesore. Krahasuar me planin vjetor rezulton si më poshtë:

Shpenzimet korente	<b>98%</b>
Shpenzimet kapitale	<b>79 %</b>
<b>Gjithsej</b>	<b>95 %.</b>

Në këtë program janë parashikuar për t'u realizuar produktet e mëposhtem, ecuria e të cileve krahasuar me planin vjetor paraqitet ne tabelën ne vijim:

Kodi i Produkti	Emri i Produktit	Buxheti Vjetor 2010	Buxheti Vjetor Rishikuar 2010	Fakti 12mujor 2010	Realizimi ne %
B	Autonomia shkollore ne arsimin e mesem te pergjithshem.	64,000.0	0.0	0	0
C	Hartimi kurrikulave te reja si dhe rishikimi i kurrikulave te Arsimit te Mesem te Pergjithshem.(IKT), standardet ndertimore (CBA)	69,325.0	3,994.6	3,163	79%
A	Realizimi i sherbimit arsimor, krijimin e shanseve të barabarta për të gjithë nxënësit për një arsimim cilësor, masiv dhe bashkëkohor, mirëmenaxhim të burimeve njerzore, fuqizimin dhe rritjen e autonomisë shkollore.	3,964,984.0	4,219,528.6	4,174,269	99%
F	Sigurimi i teksteve shkollore per nxenesit e arsimit te mesem te pergjithshem.	33,000.0	47,633.4	42,813.9	90%
D	Trajnimi i mesuesve, per kurrikulat e reja ne gjimnaze dhe zhvillimin profesional.CBA	23,000.0	24,381.0	8,030	33%
G	Veprimtari Ekstrakurrikulare ne Arsimin e Mesem te Pergjithshem.	3,800.0	3,800.0	3,500	92%
E	Vleresimi i nxenesve ne maturen shteterore nga Agjencise Kombetare te Vleresimi te Arrijjeve te Nxenesve(AVA)+(APRIAL)	78,607.0	90,607.0	88,618	98%
A	Furnizimi me pajisje laboratorii kimie, fizike, biologjie per shkollat e mesme te pergjithshme dhe te bashkuara	202,885.0	52,885.0	0	0%
A	Projekti i Keshillit Europes me Bashkine e Tiranës	52,000.0	52,000.0	43,927	84%
A	Ndertimi i shkollave te reja.	631,626.0	374,814.0	340,728	91%
A	Rehabilitimi dhe zgjerimi i shkollave ne arsimin e mesem.	166,373.0	171,819.0	170,743	99%
A	Furnizimi me pajisje mobilerie te shkollave te reja dhe te rehabilituara.	82,270.0	74,270.0	37,586	51%
A	Pajisje mobilerie per kabinetet e informatikes	0.0	0.0	0	
A	Pajisje mobilerie per laboratoret kimi fizike biologji dhe IT.	14,000.0	6,000.0	0	0%
A	Krijimi i bibliotekave ne arsimin e mesem te pergjithshem(blerje librash per bibliotekat).	20,000.0	20,000.0	16,001	80%
A	Shtimi i laboratoreve mesimore te IT ne AMP.	103,660.0	24,660.0	1,288	5%
	<b>TOTALI</b>	<b>5,509,530</b>	<b>5,166,393</b>	<b>4,930,667</b>	<b>95%</b>

#### Sa me sipër, disa produkte nuk janë realizuar;

1. Shkolla që përfitojnë autonomi financiare, procedurat janë në vazhdim;
2. Ndryshimit të procedurave për objektet apo kontrata në vazhdim si dhe projektet e reja si me fondet e buxhetit të shtetit procedurat e reja VKM nr. 135, datë 3.2.2010, si dhe udhëzimi i Ministrisë të Financave nr. 11, datë 1.04.2010, si dhe me fondet në kuadër të projektit Cilësi dhe Barazi në Arsim;

**Faktorët që kanë ndikuar në realizimin e buxhetit për 6mujorit 2010, janë cituar në programin e arsimin bazë.**

#### **IV - ARSIMI I MESËM PROFESIONAL (Titulli i programit 09240).**

Buxheti i rishikuar për këtë program është planifikuar **2 miliard e 274 milion lekë** dhe zë 5.7% të buxhetit të MASH. Realizimi shpenzimeve të buxhetit për periudhën 12 mujore ndaj planit vjetor në këtë program është **82%**.

##### ***Objektivat kryesorë***

##### **a. Rritja e atraktivitetit dhe diversifikimi i APT.**

- Ndjekja e Arsimit Profesional nga 30% e nxënësve të arsimit të mesëm, duke zbatuar strukturën “2+1+1”, “2+2”, “4”, vite shkollim për APT dhe 3/4 vite shkollim për ASK;
- rishikimi i 30 skeletkurrikulave të kualifikimeve profesionale për klasat 2,3,4;
- hartimi i 50 programeve të reja për lëndët tekniko-profesionale e social-kulturore
- hartimi i 70 skeletkurrikulave të kualifikimeve të reja profesionale (Socialkulturore);
- hartimi i 10 teksteve të integruara për lëndët profesionale;
- trajnimi i 400 mësuesve të APT dhe të ASK;
- rritja e numrit të mësuesve me 3% ndaj numrit të përgjithshëm (rreth 50 mësues);
- modernizimin e praktikave mësimore në 15 shkolla tekniko-profesionale dhe në 4 shkolla social-kulturore;
- instalimi i 5 laboratorëve kimi- biologji, 10 laboratorëve fizikë, 20 laboratorë informatike;
- modernizimi i praktikave profesionale nëpërmjet pajisjes me mjete makineri dhe pajisje për shkollat e AP/Sk dhe S (rreth 25 780 nxënës, 5 reparte të reja);

##### **b. Përputhja e ofertës së profesioneve me kërkesën e tregut duke realizuar ;**

- ✚ vazhdon plotësimi i ciklit të plotë 2+1+1 të shkollës elektrike në TIK në Tiranë, hapjen e një dege Sociale në shkollës agrobiznes Kamëz, hapjen e shkollës agrobiznes e veterinarit në Bushat, hapjen në shkollës agrobiznesit Trush, në shkollës profesionale Kukës, të shkollës profesionale Dibër, hapja e disa degë të reja studimi;
- ✚ hartimi i 25 programeve shkollore në bashkëpunim me biznesin, për lëndët profesionale;
- ✚ dizenjimi i 8-të studim-projektim për rikonstrukcion e ndërtim konviktesh të reja dhe projekte të shkollave të reja;
- ✚ zgjerim kapacitetesh mësimore dhe laboratorëve didaktike, rehabilitim për rreth 100 klasa mësimore e 34 dhoma e mjedise konviktesh
- ✚ mobilimi i 34 dhoma për akomodim, sallave për studim, si dhe pajisje për kuzhinat;
- ✚ mobilimi i 20-25 klasa mësimore dhe laboratorëve didaktike;
- ✚ motivimi me bursa të rreth 1600 nxënësve, duke dhënë përparësi nxënësve që studiojnë në vitin e parë në drejtimin mësimor **bujqësi, pyje, veterinarit dhe ndërtim;**
- ✚ akreditimi i 5 shkollave të APT sipas standardeve të AKAFP.

##### **Shpenzimet korrente për këtë program janë planifikuar 1 miliard e 872.8 milion lekë.**

Shpenzimet për pagat dhe sigurimet shoqërore (artikulli 600/601) janë parashikuar **1 miliard e 537 milion lekë** për rreth 2,253 punonjës. Buxheti është detajuar për 13 DAR, 10 ZA dhe 21 shkolla profesionale e socialkulturore me status kombëtar. Realizimi i shpenzimeve operative/korrente për periudhën 12 mujore ndaj planit vjetor, në këtë program është në masën **95%**.

- ✓ Shpenzimet operative/korrente janë realizuar në vlerën 251 milion lekë ku përfitues janë rreth 19 800 nxënës.
- ✓ Për DAR/ZA dhe Aparati i MASH për blerje materiale dhe mjete didaktike, **15.5 milion lekë**,
- ✓ Buxheti për shkollat profesionale e social kulturore nacionale për blerje materiale dhe mjete **didaktike 85.5 milion lekë**.
- ✓ Agjencia Kombëtare e Arsimit dhe Formimit Profesional, Tirane **9.9 milion lekë**;
- ✓ Bursat e nxënësve ose kuotë ushqimore **134 milion lekë** për afro 3800-4500 nxënës, si dhe bursat për 42 nxënës të shkollës Austriake ”Peter Mahringer” Shkodër rreth **4 milion lekë**
- ✓ **Shpenzime për në artikullin 606**, - Kompesimi i blerjes së teksteve shkollore për rreth 2500 mijë nxënës **2.1 milion lekë**

**Shpenzimet kapitale të këtij programi janë në masën 402 milion lekë**, disa nga projektet kryesore janë

- ✓ Fondi për zhvillimin rajonal **66.9 milion lekë**, nga të cilat **2.5 milion lekë** për objekte në vazhdim nga viti 2009, të përealizuara sepse si psoje e celjes me vonesë të fondit, pushteti vendor ka bërë likuidimin nga fondet e veta, **64.4 milion lekë** për pajisje mobilierie për konvikte të realizuara 81%, nga ulja e vlerave kontraktuale konkurruese.
- ✓ Rikonstruksion i shkollës së Gjuhëve të Huaja, detyrim 2009, prej **15 milion lekë** i realizuar **100%**.
- ✓ Rikonstruksione ( 9 shkolla dhe baza prodhuese) **122.9 milion lekë**, të përealizuara, janë duke u kryer procedurat e prokurimit nga vetë donatorët.
- ✓ Pajisje kompjuterike prej **15 milion leke**, për të cilat është lidhur kontrata, por do të realizohen në vitin 2011
- ✓ Pajisje mobileri për laboratore - **30.2 milion lekë**, realizuar **6 milion lekë**.
- ✓ Pajisje laboratorike **70 milion lekë**, të cilat nuk janë realizuar, janë duke u krye procedurat nga vetë donatorët
- ✓ Kabinete informatike **24 milion lekë**, të cilat nuk janë realizuar, janë duke u krye procedurat nga vetë donatorët
- ✓ Pajisje teknologjike **20 milion lekë**, të cilat nuk janë realizuar, janë duke u krye procedurat nga vetë donatorët

Në këtë program investimet janë kryesisht me burim financimi të huaj rreth 276.2 milion lekë ose 68%, ndërsa financimi i brendshëm 125.9 milion lekë ose 27%.

- ✓ Financimi nga fondi i zhvillimit rajonal 66.9 milion lekë .
- ✓ Financimi nga buxheti për rikonstruksion të shkollave profesionale 15 milion lekë.
- ✓ Financimi nga buxheti për pajisje kompjuterike të shkollave profesionale 35 milion lekë.
- ✓ Financimi nga buxheti për pajisje të tjera të shkollave profesionale 6 milion lekë
- ✓ Financimi i TVSH për projektet e vogla të huaja në arsimin e mesëm profesional 2.9 milion lekë
- ✓ Financim i huaj 142.9 milion lekë kryesisht për projektet IPA 2008 120 milion me "CARDS" 20 milion ,
- ✓ Projekti i Qeverisë Zvicerane "Klasa për edukimin e alternuar " 54.241 milion leke
- ✓ Projekti i Qeverisë Zvicerane "Edukimi profesional shqiptar dhe program trajnimi" 81.893 milion lekë

Realizimi i shpenzimeve për 12 mujorin 2010 në këtë program është në masen 82 % dhe përfaqëson rreth 61.7% të totalit të shpenzimeve të realizuara sipas zërave kryesore. Krahasuar me planin vjetor rezultoi si më poshtë:

Shpenzimet korentë **95%**  
 Shpenzimet kapitale **18 %**  
**Gjithsej 82 %.**

Në këtë program janë parashikuar për t'u realizuar produktet e mëposhtem, ecuria e të cileve krahasuar me planin vjetor jepet në tabelë:

Kodi i Produktit	Emri i Produktit	Buxheti Plan 2010	Buxheti i Rishikuar 2010	Fakti 12 mujor 2010	Realiz % 2010
F	Akreditimi i drejtimeve të studimit/ shkollave nga AFP	31,472	30,472	19,076.4	63%
D	Hartimi i teksteve të integruara për lëndet profesionale.	3,000	2,569	2,100.0	82%
G	Mbeshtetje financiare me burse për nxënësit në nevojë si dhe në dege të rëndësishme të ekonomisë.	230,000	153,428	136,526.0	89%
A	Përgatitja e skelet-kurrikulave të kualifikimeve të reja profesionale dhe rishikimi i kurikulës aktuale.	3,600	4,600	3,751.2	82%
E	Programet mesimore të përmirësuar në bashkëpunim me biznesin.	2,500	2,500	2,173.0	87%
C	Trajnimi i mesuesve që i përkasin arsimit profesional e social-kulturor.	10,000	5,000	2,600.0	52%
B	Zgjerimi dhe rritje e pranimit në AFP, nëpërmjet hapjes së programeve të reja të studimit në përputhje me nevojat e tregut vendas, rajonal dhe me gjere	1,646,084	1,674,215	1,621,894.0	97%
H	Blerje e pajisjeve për laboratore mesimore mesimdhënies	40,000	50,000	0.0	0%
I	Blerje pajisje për krijimin laboratorëve të lëndëve profesionale në AMP	30,000	38,000	0.0	0%
A	Projekti CARDS Komisioni Europian Blerje e pajisjeve mesimore të bazave prodhuese- didaktike.	20,000	20,000	0.0	0%
A	Blerje pajisje elektronike për Krijimi i laboratorëve të informatikës për AP.	24,000	59,000	0.0	0%
O	Blerje pajisje mobilierie për klasat, laboratorët dhe kabinetet e rinj.	24,224	30,296	6,072.0	20%
N	Hartimi dhe dizajni i projekteve ndërtimore, për shkollat e reja si dhe rikonstruksionet e objekteve të Arsimit profesional si dhe bazave mesimore e didaktike.	3,000	0	0.0	0
L	Ndërtimi i shkollave Programi IPA (BE), për ndërtimin dhe rikonstruksionin e shkollave Profesionale.	144,000	122,928	660.0	1%
M	Reabilitimi i objekteve në shkolla profesionale dhe bazave prodhuese didaktike	0	15,000	14,913.0	99%

J	Ndertimi konvikteve te reja ne AFP, me synim permiresimin e infrastruktures dhe krijimin e kushteve per te synuar plotesimin e objektivit te QSh	15,000	0	0.0	0
A	Pajisja e konvikteve dhe Kuzhinat.	64,454	64,454	52,176.0	81%
K	Rehabilitimi i konvikteve eksistues.	2,514	2,514	0.0	0%
		<b>2,293,848.0</b>	<b>2,274,976.0</b>	<b>1,861,941.6</b>	<b>82%</b>

**Nga tabela e mësipërme evidentohet se disa produkte nuk janë realizuar;**

1. Përgatitja e teksteve shkollore të integruara ky produkt është në proces.
2. Të gjitha produktet të planifikuara për vitin në grupin e investimeve kapitale nuk janë realizuar për shkak të mos miratimit të planit të buxhetit nga Ministria e Financës për vitin 2010 dhe “ngrirja e fondeve” për këtë program buxhetor.
3. Ndryshimit të procedurave për objektet apo kontrata në vazhdim si dhe projektet e reja si me fondet e buxhetit të shtetit procedurat e reja VKM nr. 135, datë 3.2.2010, si dhe udhëzimi i Ministrit të financave nr. 11, datë 1.04.2010.

**Faktorët që kanë ndikuar në realizimin e buxhetit për 12 mujorit 2010, janë të njëjtë me faktorët që kanë afektuar mosrealizimin në arsimin bazë.**

**V - INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË. (Titulli i programit 09450)**

Buxheti i planifikuar për këtë program kapin vlerën **6 miliard e 168 milion** lekë. Shpenzimet e buxhetit të arsimit të lartë zenë 18.4% të shpenzimeve të buxhetit të MASH (së bashku me të ardhurat e IAL **2.8 miliard leke buxheti i IAL shkon në 21.8 %**). Realizimi shpenzimeve të buxhetit për periudhën 12 mujore ndaj planit vjetor në këtë program është në **masën 95%**.

**Objektivat kryesorë**

- 1). Përmirësimi i cilësise se mësimdhënies dhe e njohurive në sistemin e AL nëpërmjet
  - a) stimulimit dhe hapjes së rreth 30 kurrikulave të reja të ciklit të dytë dhe 15 programeve studimi të ciklit të tretë në fushën e Teknologjise se Informacionit, në përputhje me standartet europiane;
  - b) përmirësimit të metodës së mësimdhënies nëpërmjet trajnimit të stafit akademik duke e çuar në 30% stafin e trajnuar për metodat e mësimdhënies, pasurimit të 20 % të laboratorëve dhe bibliotekave;
  - c) rritja e numrit të pedagogëve nga 3000 që janë në vitin 2010 në 4000 në vitin 2011.
- 2). Sigurimi i cilësise se programeve të studimit, nëpërmjet:
  - a) ngritjes së grupeve të vlerësimit të brendshëm në të gjitha IAL-të
  - b) akreditimit institucional të IAL-eve dhe i të gjitha programeve të tyre të studimit në ciklin e parë me kohë të plotë deri në masën 50% dhe 20 % të programeve me kohë të pjesshme.
- 3) Zgjerimi i sistemit të Arsimit të Lartë nëpërmjet:
  - a) rritjes së pranuarve nga shkollat e mesme me 5% ose rreth 1.500 studentë më shumë se në vitin paraardhës.
  - b) zgjerimit të mjediseve të IAL-eve duke rikonstruktuar ndërtesat konform standarteve bashkohore dhe duke ngritur godinat e reja.
  - c) shtimit të numrit të studenteve në Teknologji informacioni, matematikë, fizikë dhe shkencë inxhinerike nga 13 % në 35%;
  - d) ofrimi i programeve 2 vjeçare nga universitetet rajonale
- 4) Rritja e autonomisë së IAL-ve nëpërmjet,
  - a) Rritjes së autonomisë financiare të IAL-ve dhe sigurimi i të ardhurave nga tarifat dhe shërbimet deri në 35% të buxhetit të tyre.
  - b) rritjen e dimensionit social nëpërmjet tarifave të shkollimit të diferencuara, shtimit të numrit të bursave financiare për studentët nga grupe shoqërore në nevojë .
- 5) Përthithja e kontigjentit cilësor të të diplomuarëve dhe kualifikuarve jashtë vendit, nëpërmjet mekanizmave motivues.

**Për institucionet publike të arsimit të lartë (IAL),**

**Buxheti i shpenzimet korrente të planifikuara prej 5 miliard e 410 milion lekë është realizuar në masën 97% ose 5 miliard e 262 milion lekë.**

Buxheti është detajuar në 12 Universitete dhe shkolla të tjera të larta, dhe 4 institucione të sistemit të arsimit të lartë, për afro **95.750** studentë në drejtime të ndryshme studimi.

- ✓ **Shpenzimet për zërin Pagat dhe sigurimet shoqërore** të punonjësve **në artikullin 600/601** janë planifikuar 167.5 milion lekë për punonjësit e katër institucioneve si Qendra Studimeve Albanologjike Tiranë, Agjensia e Akreditimit Tiranë, Klubi Sportiv Studenti, Tiranë, Shtëpia Botuese e Librit Universitar, Tiranë.
- ✓ **602.shpenzimet operative** 68.5 milion lekë, ku përfshihen shpenzimet e funksionimit (QSA, KS, SHBLU, AA)
- ✓ Aktiviteteve në kuadër të projektit “Cilësi dhe Barazi në Arsim” janë realizuar 21.5 milion lekë
- ✓ **603.Subvencionet** e Sh.a “Trajtimi i Studentëve” në Tiranë dhe në rrethe janë **375.1 milion** lekë për rreth 14.500 studentë, realizimi është në masën 99%.
- ✓ **Për institucionet publike të arsimit të lartë (IAL)**, shuma prej **4 miliard e 335 milion lekë** (artikulli 604) paraqet shumën totale të marrë nga buxheti për “transfertën e pakushtëzuar” me një shkallë të lehtë rritje ndaj vitit 2009. Fondet për universitetet shpërndahen në formën e grantit të pakushtëzuar. Universitetet nëpërmjet organeve kolegjiale detajojnë këtë grant sipas njësive shpenzuese dhe zërave përkatës të buxhetit, realizimi është në **masën 99%** ose **4 miliard e 275 milion lekë**.
- ✓ Jane hapur deri tani në ciklin I-re 41 programe , ciklin II-të 69 mastera profesionale dhe 82 mastera shkencore, ciklin III –të 125, nga të cilat 90 programe të doktoratës (nga të cilat 17 të reja) dhe 35 programe studime specializimi afatgjate (ku janë 5 programe të reja)
- ✓ Janë rishikuar kurikulat/programet miratuar deri tani në ciklin I-rë të studimeve 41 programe , në ciklin II-të 69 mastera profesionale dhe 82 mastera shkencore, në ciklin III –të 125, nga të cilat 90 programe të doktoraturës (nga të cilat 17 të reja) dhe 35 programe studime specializimi afatgjatë (ku janë 5 programe të reja. Janë miratuar gjithsej 90 programe të doktoraturës nga të cilat 17 janë programestudimi të miratuara për herë të parë, rishikuar kurrikulat e 7 programeve të doktoratës.
- ✓ Gjatë vitit 2010, janë realizuar 2 procese akreditimi institucional, 3 procese akreditimi institucional, 17 akreditime programesh, 13 procese akreditimi programesh dhe një proces akreditimi është në vazhdimësi.

**Shpenzime për në artikullin 606. Bursat e studentëve**– 362 milion lekë për rreth 5000 -5500 studentë që trajtohen me bursë nga IAL publike realizimi është në masën **96%**.

**Shpenzimet kapitale për këtë program janë 758 milion lekë lekë**, me projekte kryesore:

- ✓ Fondi për zhvillimin rajonal 2010 prej 413.7 milion lekë për likuidimin e objekteve në vazhdim në arsimin e lartë, ndërtime të reja 289.4 milion lekë, realizuar 100%, rikonstruksione 116.4 milion lekë,realizuar 100%, studim projektim 1.7 milion lekë nga viti 2009, pa realizuar nga QSA.
- ✓ Pajisje laboratorit –kërkimorë e shkencorë – **267 milion lekë**, realizuar **65.9%**, me financim në kuadër të projektit ”Cilësi dhe Barazi në Arsim”.
- ✓ U financuan 184.9 milion lekë, për kontrata të lidhura 2009-2010, për pajisjen e 18 laboratorëve të arsimit të lartë në 3 universitete të vendit, Universitetin e Tiranës, Universitetin Politeknik dhe Universitetin Bujqësor, fond i cili u realizua me një vlerë prej 176 milion lekë. Nuk u realizua vetëm një kontratë e Universitetit të Tiranës, si pasojë e mosrespektimit të kontratës nga firma fituese.
- ✓ U financuan 90.3 milion lekë, për projektet e pajisjes së 25 laboratorëve të arsimit të lartë, në 10 universitete të vendit, të miratuar për vitin 2010, të cilat nuk u realizuan për arsye të financimit pjesor të tyre (m 50%) gjatë vitit 2010.
- ✓ Financimi për projektet e huaja në arsimin e lartë (Tempus +Rrjeti telematik ) 76.6 milion lekë, të cilat nuk janë realizuar.

**Realizimi i shpenzimeve** për 12/mujorin e parë 2010 në këtë program është **20%** dhe përfaqëson rreth 15.7% të totalit të shpenzimeve të realizuara kësaj ministrie, sipas zërave kryesore, krahasuar me planin vjetor rezultojn si më poshtë:

Shpenzimet korente	<b>97 %</b>
Shpenzimet kapitale	<b>77 %</b>
<b>Gjithsej</b>	<b>95 %</b> (nese do te shtojme edhe te ardhurat e veta realizimi eshte 93%)

Në këtë program janë parashikuar për t’u realizuar produktet e mëposhtem, ecuria e të cileve krahasuar me planin vjetor jepet në tabelë:

Kodi i Produktit	Emri i Produktit	Buxheti Plan 2010	Buxheti i Rishikuar 2010	Fakti 6 mujor 2010	Realiz %
------------------	------------------	-------------------	--------------------------	--------------------	----------

					2010
P	Ekspertize dhe konsulence ndërkombetare për implementimin e procesit të bolonjes në IAL (CBA)	102,047	26,257	21,735	82.8%
F	Ekspertize ndërkombetare për akreditimin e Agjensisë së Akreditimit dhe IAL.(CBA)	10,000	2,000	0	0.0%
C	Hapen programe të reja studimi sidomos nga IAL rajonale për t'iu përgjigjur tregut të punës dhe zhvillimit rajonal.	15,000	15,000	15,000	100.0%
H	Mbeshetje financiare për QSA kerkuesit e rinj në master, doktorature dhe pastdoktorature në QSA	219,960	217,680	166,680	76.6%
G	Mbeshetje financiare për studentet nga shtresa sociale në nevojë me bursa dhe akomodim.	700,000	755,415	452,010	59.8%
B	Ristrukturimi i kurrikules dhe hartimi i kurrikulave të reja.	6,000	6,000	6,000	100.0%
A	Transferta e pakushtezuar për realizimin e autonomisë financiare të IA	5,159,285	4,293,683	4,520,052	105.3%
Q	Veprimtari të Institucioneve mbeshtetese IAL (SHBLU,KS)	63,490	55,530	48,576	87.5%
D	Vleresime të brendshme të sigurimit të cilesise në IAL për një proces cilesor të sigurimit të cilesise.	19,000	10,000	8,200	82.0%
E	Vleresime dhe akreditime të IAL, për një proces cilesor të sigurimit të cilesise.(AAAL)	34,724	28,796	23,911	83.0%
O	Hartimi dhe dizejimi i projekteve ndertimore dhe rikonstruksioneve ndertimore.	11,742	1,742	0	0.0%
M	Krijimi i bibliotekave dixhitale për rritjen e cilesise së mesimdhënieve dhe kerkimit shkencor	0	0	0	
L	Krijimi i laboratoreve të Informatikes IT, si rrjeti i telematik nderuniversitar.	64,100	64,100	0	0.0%
N	Krijimi i laboratoreve teknologjike dhe me karakter teknik në IAL.	12,500	12,500	0.0	0.0%
K	Krijimi i laboratoreve kerkimore e shkencore me pajisje të standarteve bashkohore.(CBA).	367,736	267,736	176,076.0	65.8%
I	Ndertime të reja për shtimin e kapaciteteve si dhe persimin e standarteve në IAL	289,439	289,439	289,439.0	100.0%
A	Pajisje audioresh dhe zyra departamentesh në IAL	90,291	6,062	0.0	0.0%
J	Reabilitimi i godinave ekzistuese për shtimin e kapaciteteve si dhe permiresimin e standarteve të akomodimit në IAL. zgjerimi i sistemit të IAL me drejtime të reja studimi si dhe plotesimi i tre cikleve të studimit.	106,490	116,490	115,988.0	99.6%
	TOTALI	7,271,804.0	6,168,430.0	5,843,667.8	95%
	Shpenzime jashte buxhetore		2,802,344.0	2,469,404.8	
	TOTALI		8,970,774.0	8,313,072.6	

#### Nga tabela e mësipërme evidentohet se disa produkte nuk janë realizuar;

1. Ekspertize dhe konsulence ndërkombëtare për implementimin e procesit të Bolonjës në IAL (CBA)
2. Ekspertize ndërkombëtare për akreditimin e Agjensisë së Akreditimit dhe IAL.(CBA) procedurat janë në vazhdim;
3. Produktet e planifikuara për vitin 2010 në grupin e investimeve kapitale, nuk janë realizuar në masën e duhur për shkak të “**ngrirjes së fondeve**” nga Ministria e Financës për vitin 2010.
4. Mosçeljes së detyrimeve për objektet në vazhdim nga viti 2009, nga Ministria e Financës për vitin 2010.
5. Ndryshimit të procedurave për objektet apo kontrata në vazhdim si dhe projektet e reja si me fondet e buxhetit të shtetit VKM nr. 135, datë 3.2.2010, si dhe udhëzimi i Ministrisë të Financave nr. 11, datë 1.04.2010, si dhe me fondet në kuadër të projektit **Cilësi dhe Barazi në Arsim**”;

#### VI -Kërkimi Shkencor. (Titulli buxhetor i programit 09770)

Fondet për këtë program janë planifikuar në total në vlerën **228 milion lekë**

#### Objektivat kryesorë

- ✚ Organizim seminaresh e takimesh formuese/informuese mbi Programet Kombëtare, Ndërkombëtare dhe Programin e Shtatë Kuadër.
- ✚ Zhvillimi i politikave strategjike për të rritur potencialin e Kërkimit Shkencor në vend.
- ✚ Përgatitja e legjislacionit të ri për Kërkimit Shkencor që harmonizim zhvillimin e sektorit të kërkimit shkencor me sektoret prioritare të ekonomisë, nxit investimet vendase dhe të huaja në kërkim dhe zhvillim.
- ✚ Futja e indikatorëve të OECD për hartimin dhe vlerësimin e veprimtarisë kërkimore shkencore, për të ndërtuar politika eficiente në këtë fushë. ,
- ✚ Pjesëmarrja në programet evropiane të RTD.
- ✚ Implementimi i programeve dypalëshe që mund të bëhen aktive (Austria, Turqia, Polonia)
- ✚ Nënshkrimi i marrëveshjeve të reja dypalëshe me Kosovën dhe Mali i Zi.Integrimi i 8 doktoraturave në projektet dypalëshe të kërkimit shkencor me Kosovën dhe Kroacinë .

- Zhvillimi i potencialit të bashkëpunimit të Universiteteve dhe biznesit privat në programet kombëtare të kërkimit dhe zhvillimit, në marrëveshjet dypalëshe dhe shumëpalëshe, si dhe financimi i projekteve,.

### Projekte që përfituan financim në vitin 2010;

Promovimi i Programeve Kombëtare dhe Ndërkombëtare të Kërkimit dhe Zhvillimit, nëpërmjet Konferencave dhe Seminareve të organizuara nga MASH (QSA)

- Pagesa e projekteve multilaterale dhe bilaterale**, (vetëm për pjesën e shpenzimeve korente të vitit 2009, pjesa e fondeve për shpenzime kapitale për vitin 2010 i ka kaluar Agjencisë Shqiptare të Kërkimit).
- Pagesa e kuotës vjtore për projektet në kuadrin e FP 7**, etj. Në zbatim të ligjin nr. 9866, datë 31.01.2008 "Për ratifikimin memorandumit të mirëkuptimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Europian, për asociimin e Republikës së Shqipërisë në Programin e Shtatë Kuadër të Komunitetit Europian, për kërkimin, zhvillimin teknologjik dhe të veprimtarive të demonstrimit 2007-2013", janë realizuar pagesat për vitin 2010 të FP7 në shumën prej 1,035,367.49 EURO, si dhe pagesa SEE-ERA.NET PLUS", Grant agreement nr. 226156 të Programit të Shtatë Kuadër të Komisionit Europian rreth 30 000 Euro.
- Mbështetja e ekselentëve që studiojnë në 10-të universitetet të mira të botës**, studentët që kanë rezultate në studime me notën mbi 9.5 (mbështetje për ekselencën). Janë vlerësuar praktikant aplikimit të "Fondit të Ekselencës 2010", për studentet që ndjekin studimet në 10 universitetet më të mira të botës, studimet master si dhe studime në doktoraturë dhe postdoktoraturë janë vlerësuar **77 aplikante** dhe janë shpallur fitues/përfitues 42 studente për vitin 2010, si dhe trajtimi i 10 studentë fitues të vitit të dytë shpallur fitues 2009. (të detajuar, 37 studente Dr, 7 studente post Dr, 2 studente Master, 4 studente bachelor si dhe 2 studente vleresim me cmime).
- Eshte siguruar mbështetje financiare për konferencën e rëndesishme të vecantë për Qendrën e Studimeve Albanologjike Tiranë

**Realizimi i shpenzimeve për 12 mujorin 2010** në këtë program është **100%** dhe përfaqëson rreth 0.6% të totalit të shpenzimeve të realizuara, sipas zërave kryesore, krahasuar me planin vjetor rezulton si më poshtë:

Shpenzimet korente	100%
Shpenzimet kapitale	0%
<b>Gjithsej</b>	<b>100%</b>

Në këtë program janë parashikuar për t'u realizuar produktet e mëposhtem, ecuria e të cileve krahasuar me planin vjetor jepet në tabelë:

Kodi i Produktit	Emri i Produktit	Buxheti Plan 2010	Buxheti i Rishikuar 2010	Fakti 12 mujor 2010	Realiz % 2010
A	Promovimi i Programeve Kombetare dhe Nderkombetare te Kerkimit dhe Zhvillimit, nepermjet Konferencave dhe Seminareve te organizuara nga MASH	3,000	2,000	1,820.70	91%
B	Mbeshtetje financiare per kerkuesit dhe shkencetaret e rinj qe kryejne studimet e tyre Universitare dhe pas Universitare jashte vendit.	100,000	<b>74,000.0</b>	73,854.6	100%
C	Programi Kerkimor Universitar dhe i Shkollave te larta.	0	0	0.00	0%
D	Mbeshtetje per pjesmarrjen ne Projektet ne kuader te FP7.	142,000	149,000.0	148,977.0	100%
E	Projekte te Rendesise se vecante.(QSA)	3,000	3,000	2,997.40	100%
F	Programet Nderkombetare te Bashkepunimit Shkencor e Teknologjik	2,000	0	0.00	#DIV/0!
	<b>TOTALI</b>	<b>250,000</b>	<b>228,000</b>	<b>227,649.7</b>	<b>100%</b>

## Aneks 2 ;RAPORT 12 MUJOR "PER PROJEKTIN CILESI DHE BARAZI NE ARSIM"

**Projekti "Cilësi dhe Barazi ne Arsim"** është një projekt në mbështetje të programit të reformave në arsim dhe një instrument i rëndësishëm në mbështetje të realizimit të objektivit të Qeverisë Shqiptare drejt një arsimi cilësor.

Ky projekt, në formatin SĚAP, zbatohet nga strukturat e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe instituteve të varësisë, nëpërmjet programeve vjetore të reformës. Projekti financohet nga Qeveria Shqiptare, Banka Botërore, Banka e Këshillit të Evropës për Zhvillim dhe Banka Europiane për Investime.

**Objektivi kryesor i projektit** është përmirësimi i cilësisë së kushteve të mësimdhënies dhe mësimnxënies për të gjithë nxënësit dhe studentët, si edhe rritja e frekuentimit në arsimin e mesëm të përgjithshëm, në veçanti për të varfërit.

Për zbatimin e projektit “Cilësi dhe Barazi në Arsim”, si çdo vit, MASH ka hartuar në bashkëpunim me njësitë zbatuese të tij, Planin Vjetor të Reformes 2010 e cila është miratuar edhe nga tre bankat donatore. (referuar Urdhërit nr 134, datë 03.03.2010 “Për miratimin e PVR 2010 në kuadër të CBA”)

Buxheti i Planit Vjetor të Reformes (PVR) i miratuar nga Donatorët për 2010 ishte rreth 3,219,152,252 Lekë. Plani fillestar të buxhetit, i miratuar nga Ministria e Financave ai ishte në vlerë totale 2,222,415,583 leke i ndare në shpenzime operative në shumën 338,748,583 dhe për investimet 1,883,667,000 leke.

Pas Rishikimit të tij nga Ministria e Financave me aktet normative në muajin Korrik 2010 plani u reduktua në vlerën totale 1,209,728,139 leke të ndare në shpenzime operative 135,686,164 leke dhe në investime në vlerë 1,074,041,975 leke .

Te dhenat e detajuara si për planin fillestar të buxhetit si dhe të planit të rishikuar jepen në tabelën nr.1

Tabela 1.

Buxheti dhe Shpenzimet Faktike në Kuadrin e Projektit “Cilësi dhe Barazi në Arsim”, Janar-Dhjetor 2010 (në mijë leke)

Viti 2010	Plan Buxheti fillestar			Plan Buxheti i rishikuar			Realizimi Faktik		
	Artikujt			Artikujt			Artikujt		
Prioritetet dhe programet buxhetore	`602`	`231`	`230`	`602`	`231`	`230`	`602`	`231`	`230`
Prioriteti 1: Forcimi i lidërshiptit së sistemit arsimor	140,765	94,800	-	44,789	32,000	0	18,814	6,899	0
`01110` Planifikim menaxhimi	71,965	61,200	0	40,989	31,200	0	18,040	6,899	0
`09120` Arsimit Baze	65,800	33,600		800	800	0	774	0	0
`09230` Arsimit i mesëm	3,000	0		3,000	0	0	0	0	0
Prioriteti 2: Përmirësimi i kushteve të	66,020	49,000	-	43,139	13,000	0	37,867	0	0
`09120` Arsimit Baze	66,020	49,000		30,929	13,000	0	30,925	0	0
`09230` Arsimit i mesëm	0	0		12,210	0	0	6,942	0	0
Prioriteti 3: Përmirësimi dhe racionalizimi i infrastrukturës	5,020	1,258,115	28,246	3,801	482,205	13,246	1,388	312,385	4,817
`09120` Arsimit Baze	2,220	759,245	5,871	2,001	188,335	5,871	300	127,129	4,643
`09230` Arsimit i mesëm	2,800	498,870.4	22,375	1,800	293,870	7,375	1,088	185,256	174
Prioriteti 4: Përgatitja për Reformën në Arsimin e Lartë	77,200	-	-	5,214	90,375	0	4,786	54,892	0
`09450` Arsimit i lartë	77,200	-		5,214	90,375	0	4,786	54,892	0
Aktivitetet në vazhdim të Projektit nga viti 2009	49,743.6	450,878.7	2,627	38,743	440,589	2,627	25,295	381,826	750
`01110` Planifikim menaxhimi	5,198.2			5,198			2,077	0	0
`09120` Arsimit Baze	19,302.4	276,158	2,627	10,502	265,868	2,627	6,269	260,642	750
`09230` Arsimit i mesëm	0	0	0	0	0	0	0	0	0
`09450` Arsimit i lartë	25,243	174,720.7		23,043	174,720.7		16,949	121,184	0
<b>Total 2010</b>	<b>338,748.6</b>	<b>1,852,794</b>	<b>30,873</b>	<b>135,686</b>	<b>1,058,169</b>	<b>15,873</b>	<b>88,150</b>	<b>756,002</b>	<b>5,567</b>



Shpenzimet faktike sipas programeve buxhetore dhe zerave te shpenzimeve te kryera gjate periudhes 12 mujore Janar 2010- Dhjetor 2010 ne kuadër te projektit CBA, jane si me poshte:

<b>Planifikim &amp; menaxhim 1110</b>	<b>602</b>	<b>231</b>	<b>230</b>
<b>Totali 27,014,810</b>	<b>20,115,733</b>	<b>6,899,077</b>	<b>0</b>
-Konsulence lokale	6,757,735		
-Konsulence nderkombetare	6,660,128		
-Konferenca te ndryshme	2,396,984		
-Sherbim përkthimi	1,036,490		
-Publikime ne shtyp te njoftimeve	845,440		
-Vizita pune& seminare jashte vendit	1,439,630		
-Komisione& tatime honorarësh	979,326		
-Blerje pajisjesh(printera, fotokopje, etj.)		6,899,077	
<b>Arsimi Baze 9120</b>	<b>602</b>	<b>231</b>	<b>230</b>
<b>Totali 431,432,413</b>	<b>38,268,366</b>	<b>387,770,774</b>	<b>5,393,273</b>
-Konsulence lokale	941,735		
-Konsulence nderkombetare	7,147,601		
-Konferenca te ndryshme	3,039,843		
-Blerje pajisjesh didaktike	7,198,500		
-Trajnim i mesuesve IT	17,880,040		
-Komisione& tatime honorarësh	94,807		
-Blerje pajisjesh kompjuterike		6,145,010	
-Blerje paketa office		2,800,000	
-Publikime ne ndihme te mesuesve	1,965,840		
-Studim & projektim			5,393,273
-Ndertime, rehabilitime		378,825,764	
<b>Arsimi i Mesem 9230</b>	<b>602</b>	<b>231</b>	<b>230</b>
<b>Totali 193,461,388</b>	<b>8,030,272</b>	<b>185,256,766</b>	<b>174,350</b>
-Konferenca te ndryshme	355,315		
-Kuote pjesëmarrje ne CELE	1,088,221		
-Kuote pjesëmarrje PISA	5,125,960		
-Kryerje vlerësimesh kombetare(AVA)	1,460,776		
-Blerje paketa office		1,287,646	
-Studim & projektim			174,350
-Ndertime, rehabilitime		183,969,120	
<b>Arsimi i Larte 9450</b>	<b>602</b>	<b>231</b>	<b>230</b>
-Konsulence lokale	545,228		
-Konsulence nderkombetare	19,942,809		
-Konferenca te ndryshme	391,395		
-Vizita pune& seminare jashte vendit	795,173		
-Komisione& tatime honorarësh	60,581		
-Pajisje me laborator Unilab		176,075,631	
<b>Totali 197,810,817</b>	<b>21,735,186</b>	<b>176,075,631</b>	<b>0</b>

✚ Disbursimi i fondeve për periudhën Nëntor 2006- Dhjetor 2010 është në vlerën 36,214,817.73 Euro ose rreth **60.8 %** e totalit prej **59.6 milion Euro** të fondeve sipas marrëveshjes me tre Bankat Donatore CEB=5,720,000.0 Euro, IDA=6,108,996.19 Euro, BEI =5,543,062.0 Euro,dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë =9,252,766.0 Euro.

✚ Realizimi deri në 31.12.2010 është në masën 2,713,098,837.0 lekë ose 21 milion Euro ose 36% ndaj totalit të fondeve në kuadër të marrëveshjes CBA.

✚ Viti 2011 është dhe viti i fundi i zbatimit të marrëveshjes CBA dhe brenda këtij viti duhet të realizohen 64% e fondeve ose **38.6 milion Euro**.

Gjatë zbatimit të projektit janë evidentuar problemet të cilat kanë ndikuar në shkallën e realizimit dhe ecurinë e projektit. Faktorët e përmendur më poshtë që tregojnë dhe vështirësitë që ka hasur stafi i MASH gjatë implementimit të marrëveshjeve financiare CBA, si vijon;

- + Miratimi me vonesë i planit të investimeve nga Ministria e Financave (për tre vitet 2008-2010).
- + Miratimi me vonesë i Planeve Vjetore të Aktiviteteve dhe rrjedhimisht miratimi me vonesë i Planeve Vjetore të Prokurimit nga donatorët.
- + Probleme të hasura në përzgjedhjen e konsulentëve/kompanive të hartimit/disnjimit të projekteve ndërtimore të tejzgjatura me më shumë se 15 muaj.
- + Pezullimi nga Banka Botërore i projekteve ndërtimore dhe projekteve për ndërtimet e reja, financimin e shkollave gjatë periudhës Maj 2008 -Prill 2010. Pas amendimit nga Ministri i Financës të marrëveshjes financiare me IDA Prill 2010, MASH ju dha e drejta të fillojë financimin e projektimit dhe ndërtimit të shkollave të reja.
- + Probleme në procedurat e prokurimit, vonesat në miratimin e termave të referencës, specifikimeve teknike nga ana e BB, vonesat në zbatimin e procedurave të prokurimit nga njësitë përgjegjëse në MASH, si dhe nga institucione IAL publike e njësitë vendore.
- + Mosrealizimi i procedurave të prokurimit, për shkak të standardeve larta të kërkuara në procedurat e Bankes Botërore;(Procedurat e Laboratoreve të Kimisë ,Biollogjise dhe Fizikes, IT Internet etj ).
- + Kontrata apo procedura që nuk kanë penalitete për sipërmarrësit e kontratave kanë sjellë vonesa në realizim/lëvrimin/dorëzimin e produkteve apo realizimin e kontratave. (procedurat shopping/konsulentet)
- + Mosrealizimi i kontratave sipas kushteve apo mospërbushja e detyrimeve nga ana e sipërmarrësve, për plotësimin e specifikimeve teknike e dorëzimin e produkteve/mallrave sipas afateve kohore të përcaktuara kontrate kanë sjellë **mosrealizime të detyrimeve financiare të konstatuara dhe fondet e disbursuara për këtë qëllim kanë mbetur të pa shpenzuara** (p.sh. kontrata me kompaninë MP Soft Beograd për blerjen dhe instalimin e 665 laboratorëve IT në arsimin parauniversitar, si dhe Kontrata e për instalimin Internetit në 2107 shkolla në arsimin parauniversitar me kompaninë Altelekom etj).
- + Konkurenca e ulët në treg nga sipërmarrësit, në disa procedura prokurimi nuk ka pasur konkurrencë; (Procedura e prokurimit të grantit shkollor);
- + Përsërtje e procedurave të prokurimit apo kërkesat e pjesmarrësve në konkurim për të ndryshuar apo saktësuar/specifikuar më qartë kushtet, kanë sjellë përsëritje të procedurave.
- + Probleme me njësitë vendore për sigurimin e dokumentacionit ligjor të pronësisë së tokës/truallit për sheshet e ndërtimit të objekteve shkollore.
- + Ndërprerje të kontratave të ndërtimit pas daljes/shkak të problemeve të pronësisë si në Bashkinë Lezhë dhe në Bashkinë Shkodër.
- + Probleme studimore të fizibilitetit, të mjedisit në sheshet apo terrenet e përzgjedhura nga njësitë vendore për ndërtimin e shkollave.
- + Shkurtime apo “**ngrrirja**” e fondeve nga Ministria e Financave gjatë viteve 2007, 2008, 2009, 2010
- + Në vitet e para të jetës së projektit ka pasur probleme nga mosnjohja me saktësi e procedurave të prokurimit me Banke Botërore, të ndryshme nga ato të Ligjit Shqiptar të Prokurimit, prej njësite përgjegjëse të zbatimit të projektit kanë sjellë vonesa në realizimin e Planit të prokurimit.

## ***Raporti për ecurinë e realizimit të investimeve për vitin 2010***

Gjatë vitit 2010 Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka menaxhuar fondet buxhetore për shpenzime kapitale në pesë programet të miratuara si më poshtë :

1. Planifikim menaxhim
2. Arsimi bazë
3. Arsimi i mesëm i përgjithshëm
4. Arsimi i mesëm profesional
5. Arsimi i lartë

Buxheti për shpenzime kapitale sipas buxhetit të rishikuar për vitin 2010 ka qenë 4.57 miliard lekë dhe realizimi për vitin 2010 është 3.74 miliard lekë, ose në masën 82% të fondit total të investimeve. Vetëm nga Buxheti i Shtetit financimi ka qenë rreth 3.62 miliard lekë, ndërsa financimi i huaj rreth 956 milion lekë.

Në total realizimi i investimeve jepet në tabelën e mëposhtme:


Ministria		MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCES				Kodi	11
Artikulli		(1)	(2)	(3)	(4)=(2)-(3)	(5)=(3/2)*100	
Kodi	Emri	Buxheti 2010	Buxheti i Rishikuar 2010	Fakti 12 mujor 2010	Diferenca 2010		
230	Kapitale të Patrupëzuara	28,204	17,615	5,568	12,047	32%	
231	Kapitale të Trupëzuara	8,473,020	4,558,919	3,734,577	824,343	82%	
<b>Totali</b>	<b>Shpenzime Kapitale</b>	<b>8,501,224</b>	<b>4,576,534</b>	<b>3,740,145</b>	<b>836,390</b>	<b>82%</b>	

E detajuar sipas niveleve realizimi i investimeve paraqitet në tabelën si më poshtë:

( 000/ leke)

Nr	EMERTIMI I PROGRAMIT	Buxheti 2010	Buxheti I Rishikuar 2010	Realizimi 2010	Realizimi 2010 (në %)
1	PLANIFIKIM MENAXHIM	115,238	34,034	9,629	28
2	ARSIMI BAZE	4,898,511	2,605,791	2,464,917	95
3	ARSIMII MESEM I PERGJITHSHEM	1,638,823	776,448	610,273	79
4	ARSIMI I MESEM PROFESIONAL	581,484	402,192	73,821	18
5	ARSIMI I LARTE	1,267,168	758,069	581,503	77
	<b>TOTALI</b>	<b>8,501,224</b>	<b>4,576,534</b>	<b>3,740,143</b>	<b>82</b>

Në mënyrë grafike realizimi i investimeve sipas niveleve paraqitet si më poshtë:



## 1. Planifikim Menaxhimi

Fondi i rishikuar në kuadër të këtij programi ka qenë rreth 34 milion lekë, nga të cilat 31.2 milion lekë për *projektin "Cilësi dhe Barazi në Arsim"* dhe 2.8 milion lekë nga buxheti i shtetit për rikonstruksione dhe pajisje, të aparatit të MASH-it dhe institucioneve të varësisë. Realizimi në total për këtë nivel është 9.6 milion lekë ose 28%. Duhet theksuar se fondet në këtë nivel kanë qenë kryesisht të ngrira.

- Nga buxheti i shtetit është kryer financimi pjesor për rikonstruksionin e godinës së DAR Gjirokastër, detyrim i mbartur prej vitit 2009.
- Gjithashtu është kryer financimi për mbylljen e rikonstruksionit të rrjetit elektrik dhe internetit të godinës së MASH, si dhe financimi për blerje pajisjesh nga Aparati i MASH. Fondi nga buxheti prej 2.83 milion lekë është realizuar 2.73 milion lekë ose 96%.
- Për *projektin "Cilësi dhe Barazi në Arsim"* janë realizuar vetëm blerje pajisje hardware dhe software për Aparatin e MASH-it, me vlerë 6.89 milion lekë, ose 22% e fondit total të investimeve për këtë projekt.

## 2. Arsimi bazë

Fondi sipas buxhetit të rishikuar në kuadër të këtij programi ka qenë rreth 2.6 miliard lekë, dhe realizimi në total të këtij fondi është 2.46 miliard lekë ose 95%.

Nga fondi total rreth 2.08 miliard lekë janë nga buxheti i shtetit, të cilat u realizuan me rreth 2.04 miliard lekë ose 98%, rreth 44 milion lekë për mbështetje me kosto lokale dhe tvsh të projekteve për rehabilitimin e shkollave nga Bashkia Tiranë, të cilat u realizuan me një vlerë prej 30 milion lekë ose 68.5%, si dhe 476 milion lekë në kuadër të *projektit "Cilësi dhe Barazi në Arsim"* të realizuara me rreth 393 milion lekë ose 82.5%.

- **Në nivelin e arsimit bazë gjatë vitit 2010 u punua në 122 objekte arsimore me 1353 klasa ku mësojnë rreth 31300 fëmijë të nivelit të arsimit bazë.**
- Gjatë vitit 2010 u financuan rreth 48 ndërtime objektesh të reja arsimore me një fond total investimi, nga buxheti i shtetit, prej 875 milion lekë, 7 prej të cilave në vazhdim financimi në vitin 2011, dhe 41 të përfunduara. Realizimi në vlerë totale për ndërtimet e reja është rreth 858 milion lekë ose në masën 98%. Nga përfundimi i tyre përftohën 374 klasa të reja dhe nga ku përfitojnë rreth 8553 nxënës.
- Gjatë vitit 2010, nga buxheti i shtetit, përfundoi rikonstruksioni i 74 objekteve në vazhdim financimi, rikonstruksione shkollash 9 vjeçare dhe të mesme të bashkuara, me një vlerë financimi prej 747 milion lekë dhe të realizuar me vlerën prej 727 milion lekë, nga të cilat u rehabilituan 979 klasa dhe përfitojnë 22674 nxënës. Janë në vazhdim financimi për vitin 2011, 3 objekte, të cilat u financuan në fund të vitit 2010.
- Për pajisjen me mobileri u financuan, nga buxheti i shtetit, fondi prej 422.8 milion lekë, nga i cili u pajisën me pajisje mobilje të gjitha shkollat e ndërtuara dhe rikonstruktura gjatë vitit 2009-2010 me një vlerë investimi të realizuar plotësisht prej 422.2 milion lekë.
- Gjithashtu është realizuar pothuaj plotësisht fondi prej 30 milion lekë për biblioteka shkollore në arsimin bazë, realizim me vlerë rreth 25 milion lekë ose 83% .
- Gjatë vitit 2010 u krye financimi pjesor, për një pjesë të mbartur nga viti 2009, për dixhitalizimin e amzave me një vlerë të realizuar prej 9 milion lekë.

### Projekti "Cilësi dhe Barazi në Arsim"

Fondi total i akorduar për projektin "Cilësi dhe Barazi në Arsim", siç e përmendëm më lart ishte 476.5 milion lekë, i realizuar në vlerën 393 milion lekë ose 82.5%.

- U financuan ndërtimet e reja, të cilat zinin një fond prej 379.5 milion lekë , për 9 objekte të reja arsimore, nga të cilat 2 të përfunduara dhe të tjerat në vazhdim financimi në vitin 2011. Realizimi për këtë zë ka qenë rreth 362.8 milion lekë ose 95% e fondit të çelur.
- U financua rehabilitimi i 10 objekteve arsimore me vlerë 21.3 milion lekë, për të cilat, në 7 prej tyre janë duke u zhvilluar procedurat e prokurimit, ndërsa për 3 të tjerat janë duke u lidhur kontratat e hartimit dhe dizenjimit të projekteve. Realizimi në këtë është 6.2 milion lekë.
- Për dy shkollat e përfunduara, Shkolla 9-vjecare Kamëz dhe Shkolla 9-vjecare Zallmner, u realizua fondi prej 9.6 milion lekë për pajisjen me mobileri shkollore.
- Për studimin dhe projektimin e objekteve të reja dhe atyre të rehabilituara, në kuadër të këtij projekti, u financuan 8.4 milion lekë dhe u realizuan rreth 5.4 milion lekë ose 64%.
- Gjithashtu për pajisje kompjuterike fondi i akorduar prej 11.5 milion lekë u realizua 8.9 milion lekë ose 77%.
- Fondi prej 9.7 milion lekë i akorduar për pajisjen me pajisje mobileri për laboratore dhe kabinete informatike nuk u realizua.

### **3.Arsimi i mesëm i përgjithshëm**

Fondi sipas buxhetit të rishikuar në kuadër të këtij programi ka qenë rreth 776 milion lekë, dhe realizimi në total të këtij fondi është 610 milion lekë ose 78.6%.

Nga fondi total rreth 423.2 milion lekë janë nga buxheti i shtetit, të cilat u realizuan me rreth 380.9 lekë ose 90%, rreth 52 milion lekë për mbështetje me kosto lokale dhe tvsh të projekteve për rehabilitimin e shkollave nga Bashkia Tiranë, të cilat u realizuan me një vlerë prej 43.9 milion lekë ose 84%, si dhe 301.2 milion lekë në kuadër të Projektit "Cilësi dhe Barazi në Arsim" të realizuara me rreth 185.4 milion lekë ose 61.5%.

- Në nivelin e arsimit të mesëm gjatë vitit 2010 u punua në 7 objekte të reja arsimore(nga të cilat 3 janë konvikte), në vazhdim financimi nga viti 2009, me një vlerë investimi prej 168 milion lekë, e realizuar me vlerën prej 156 milion lekë ose në masën 92.8%, nga të cilat përftohen 190 klasa të reja dhe nga ku përfitojnë 1714 nxënës.
- Gjithashtu u punua në 14 objekte për rikonstruksionin e tyre, me një vlerë investimi 172 milion lekë e realizuar plotësisht. Nga këto 13 prej objekteve të rikonstruktura janë përfunduar dhe vetëm 1 objekt është në vazhdim financimi në vitin në vijim, objekt ky i miratuar në vitin 2010 dhe i financuar pjesërisht për vitin 2010. Nga përfundimi i tyre përftohen 164 klasa të rehabilituara nga ku përfitojnë rreth 4160 nxënës.
- Është realizuar në këtë nivel fondi prej 37.5 milion lekë për pajisjet shkollore.
- Është realizuar fondi prej 17.5 milion lekë për pajisjen me biblioteka shkollore.

### Projekti "Cilësi dhe Barazi në Arsim"

Fondi total i akorduar për projektin "Cilësi dhe Barazi në Arsim" për vitin 2010 ishte 301.2 milion lekë, i realizuar në vlerën 185.4 milion lekë ose 61.5%.

- U financuan ndërtimet e reja, të cilat zinin një fond prej 204.3 milion lekë , për 4 objekte të reja arsimore në vazhdim financimi në vitin 2011. Realizimi për këtë zë ka qenë rreth 183.9 milion lekë ose 90% e fondit të çelur.
- Janë financuar me një vlerë prej 5 milion lekë për blerje të pajisjeve DEMO për mësimdhënie në arsimin e mesëm, të cilat nuk janë realizuar , janë duke u kryer procedurat e prokurimit.
- Janë financuar me një vlerë prej 12 milion lekë për blerje pajisje mobilerie shkollore dhe mobilerie për laboratorët në arsimin e mesëm, të cilat nuk janë realizuar , janë duke u kryer procedurat e prokurimit.
- Janë financuar 24.6 milion lekë për pajisje kompjuterike, realizimi i të cilave është vetëm në zërin blerje sistemi operativ, paketa software për laboratorët e informatikës, me një vlerë 1.28 milion lekë. Pjesa tjetër nuk është realizuar sepse janë duke u realizuar procedurat e prokurimit.
- U financuan 52.8 milion lekë për pajisje laboratorike, të cilat nuk janë realizuar, janë duke u kryer procedurat e prokurimit.
- U financuan 2.3 milion lekë për studim projektim, nga të cilat janë realizuar vetëm 174 mijë lekë, duke qenë se edhe këtu janë duke u kryer procedurat e prokurimit.

#### 4. Arsimi i mesëm profesional

Fondi sipas buxhetit të rishikuar në kuadër të këtij programi ka qenë rreth 402 milion lekë, dhe realizimi në total të këtij fondi është 73.8 milion lekë ose 18%. Në këtë nivel financimi nga buxheti i shtetit ka qenë 125.9 milion lekë, financim i realizuar me vlerën 73.8 milion lekë ose 58.6%, si dhe financimi i huaj 276.2 milion lekë, në të cilin nuk ka realizim.

Nga buxheti i shtetit :

- U financuan 35 milion lekë për pajisje kompjuterike, të cilat nuk janë realizuar, është kryer procedura e prokurimit, është lidhur kontrata dhe mbetet për tu realizuar financiarisht në vitin 2011.
- U financuan 64.4 milion lekë për pajisje mobileri shkollore, nga të cilat u realizuan 52.2 milion lekë ose 81% . Duhet theksuar se janë financuar plotësisht detyrimet nga viti 2009, dhe për pajisjet 2010, kontrata e lidhur ka sjellë kursim të fondeve të akorduara.
- U financuan 6 milion lekë për pajisje të tjera të shkollave profesionale, të cilat janë realizuar 100%.
- U financuan 15 milion lekë për objektin "Rikonstruksion i Shkollës së Gjuhëve të Huaja, Tiranë", të cilat u realizuan 100%.
- U financuan 2.5 milion lekë për shlyrjen e detyrimit nga viti 2009 për objektin "Rrethimi i konviktit të shkollës së mesme qytet, Bajram Curri Tropojë", por rezultoi i porealizuar. Kjo sepse fondi është çelur me vonesë dhe Bashkia Bajram Curri e ka bërë financimin me të ardhurat e veta.

Me financim të huaj :

- Përsa i përket financimit të huaj, 20 milion lekë janë financim nga projekti CARDS, i cili nuk është realizuar.
- Pjesë e financimit të huaj, me vlerë prej 120 milion lekë, është financim për projektin IPA, i fokusuar për ndërtimin e shkollave profesionale dhe bazave prodhuese të tyre, projekt për të cilin janë duke u zhvilluar procedurat e prokurimit pranë Delegacionit Europian, Tiranë, si donator i këtij projekti.
- Gjithashtu pjesë e financimit të huaj, me vlerë prej 136.2 milion lekë, është dhe financimi nga Qeveria Zvicerane për arsimin profesional, i cili nuk është realizuar.

#### 6. Arsimi i lartë

Fondi sipas buxhetit të rishikuar në kuadër të këtij programi ka qenë rreth 758 milion lekë, dhe realizimi në total të këtij fondi është 581.5 milion lekë ose 76.7%. Në këtë nivel financimi nga buxheti i shtetit ka qenë 413.7 milion lekë, financim i realizuar me vlerën 405.4 milion lekë ose 97.9%, financimi i huaj me vlerë prej 76.6 milion lekë, të cilat nuk janë realizuar, si dhe 267 milion lekë në kuadër të *projektit "Cilësi dhe Barazi në Arsim"* të realizuara me rreth 176 milion lekë ose 65.9%.

Nga buxheti i shtetit :

- U financuan 289.4 milion lekë për 2 objekte të arsimit të lartë, ndërtime të reja, detyrime nga viti 2009, dhe janë realizuar 100%.
- U financuan 116.4 milion lekë për rikonstruksionin e 6 objekteve të arsimit të lartë, edhe këto detyrime nga viti 2009, dhe janë realizuar 115.9 milion lekë, pra 99.5%.
- U financua për studim projektim për Qendrën e Studimeve Albanologjike 1.7 milion lekë, të cilat nuk janë realizuar.
- Një pjesë e financimit, prej 6 milion lekë, nga fondi për zhvillimin e rajoneve nuk u detajua, si rrjedhim nuk ka realizim.

Me financim të huaj :

- U financuan 12.5 milion lekë për projektin Tempus për 4 universitete, Universitetin e Tiranës, Universitetin Politeknik, Universitetin Bujqësor, Universitetin e Sporteve, si dhe për Aparatin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, fond i cili nuk është realizuar.
- U financuan 64.1 milion lekë projekti me Qeverinë Italiane për krijimin e qendrës së informacionit, kërkimit dhe zhvillimit për arsimin e lartë, fond i cili nuk është realizuar.

#### Projekti "Cilësi dhe Barazi në Arsim"

Fondi total i akorduar për *projektin "Cilësi dhe Barazi në Arsim"* për vitin 2010, në arsimin e lartë ishte 267 milion lekë, i realizuar në vlerën 176 milion lekë ose 65.9%.

- U financuan 184.9 milion lekë, për kontrata të lidhura 2009-2010, për pajisjen e 18 laboratorëve të arsimit të lartë në 3 universitete të vendit, Universitetin e Tiranës, Universitetin Politeknik dhe Universitetin Bujqësor, fond i cili u realizua me një vlera prej 176 milion lekë. Nuk u realizua vetëm një kontratë e Universitetit të Tiranës, si pasojë e mosrespektimit të kontratës nga firma fituese.
- U financuan 90.3 milion lekë, për projektet e pajisjes së laboratorëve të arsimit të lartë, në 10 universitete të vendit, të miratuar për vitin 2010, të cilat nuk u realizuan për arsye të financimit pjesor të tyre gjatë vitit 2010.